	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>



KOSTT

Raport Vjetor 2016

(01.01.2016-31.12.2016)


Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 83/17 të datës 14 mars 2017 njëzëri miratoj Raportin vjetor për vitin 2017:

Vendimi – 170314//II-6

Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi Raportin vjetor për vitin 2016.


	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Nebih Haziri - Zyrtar Kryesor për Financa dhe Trezor	Mustafë Hasani -Kryeshef Ekzekutiv	Drita Konxheli-Radoniqi -Kryesuese e BD
Nënshkrimi			
Data	<i>Sbkuir, 2017</i>		




	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Raport Vjetor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Janar - Dhjetor 2016

1	Titulli i Dokumentit	Raport Vjetor 2016
2	Dërguesi i dokumentit	Mustafë Hasani, Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Përmbajtja</p> <p>Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT</p> <p>Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT</p> <p>1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve</p> <p>1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit</p> <p>1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja</p> <p>1.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv</p> <p>1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual</p> <p>1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it</p> <p>1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm</p> <p>1.7. Infomacionet lidhur me kapitalin dhe dividendin</p> <p>1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit</p> <p>2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv</p> <p>2.1. Arritjet kryesore</p> <p>2.2. Ngjarjet kryesore të vitit</p> <p>2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës</p> <p>2.3.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2016</p> <p>2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit</p> <p>2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit</p> <p>2.3.4. Operimi i tregut</p> <p>2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet</p> <p>2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare</p> <p>2.4. Progresi me planin e biznesit</p> <p>2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2016</p>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		<p>2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm</p> <p>2.7. Rreziqet</p> <p>Anekset</p> <p style="padding-left: 40px;">1. Sponzorimet dhe donacionet</p> <p style="padding-left: 40px;">2. Raportet e auditorit të brendshëm</p> <p style="padding-left: 40px;">3. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike</p> <p>3.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit</p> <p>3.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p>3.3. Kontratat/transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2016 nga burimet e KOSTT</p> <p>3.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës</p> <p>Lista e shkurtesave</p>
4	Data e Raportimit	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Hyrje

Raporti Vjetor për vitin 2016 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Sipas këtij Ligji, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Ky Raport është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike ndërsa përmbajtja e tij është e bazuar në “Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”, të pranuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Pas miratimit nga Bordi i Drejtorëve ky Raport do të publikohet në ueb faqen e KOSTT.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2016 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala hyrëse e Kryesueses së Bordit të KOSTT-it

Gjatë vitit 2016 KOSTT ka vazhduar punën në zhvillimin e sistemit të transmisionit me qëllim të përmbushjes së nevojave të konsumatorëve dhe palëve në tregun e energjisë.

Viti i kaluar ka qenë mjaft sfidues për KOSTT-in, pasi që në vazhdimësi është punuar në përgatitjen për implementimin e projekteve kapitale me të cilat KOSTT do të ofrojë operim të sigurtë dhe të besueshëm me standarde evropiane. Me implementimin e këtyre projekteve investive KOSTT do të arrijë kriterin e sigurisë N-1 në tërë sistemin e transmisionit.

KOSTT ka pasur angazhime intensive për të mundësuar fillimin e operimit të pavarur si zonë/bllok kontrollues, por përkundër angazhimit edhe të spektrit politik të Kosovës dhe për arsye të obstrukcioneve nga pala serbe, KOSTT nuk ka arritur që të fillojë implementimin e Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E. Si rezultat i këtyre pengesave Linja 400kV Kosovë-Shqipëri, edhe pse është përfunduar me kohë, nuk po mund të shfrytëzohet.


Në aspektin e tregut, KOSTT ka vazhduar përgatitjen e kornizës ligjore për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike. Ka marrë pjesë aktive në iniciativat regjionale për liberalizimin e tregut dhe ndërtimin e mekanizmave për të mundësuar tregtimin e lirshëm dhe pa pengesa të energjisë elektrike.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për energjinë elektrike janë plotësuar kërkesat e rregulloreve dhe direktivave të Bashkimit Evropian për shturjen pronësore të KOSTT-it. Nga muaji gusht 2016, sipas Ligjit për energjinë elektrike, të drejtat e aksionarit për KOSTT ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it dhe menaxhmenti mbeten të përkushtuar për zhvillimin e mëtejshëm të KOSTT-it dhe ofrimin e shërbimeve kualitative, gjithnjë duke pasur parasysh se zhvillimit të sistemit i paraprinë zhvillimi dhe motivimi i punonjësve të KOSTT-it.

Sinqerisht,

Drita Konxheli Radoniqi
Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 6 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT –it

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

KOSTT ka përmbyllur vitin 2016 me rezultate të rëndësishme gjithëpërfshirëse. Gjatë vitit, janë realizuar aktivitete proaktive në drejtim të përbushjes së objektivave strategjike të kompanisë dhe Planit të Biznesit. Viti 2016 njëherit ka shënuar 10 vjetorin e themelimit të KOSTT, dekadë në të cilën në mënyrë meritore ka siguruar cilësimin si një nga kompanitë më të suksesshme jo vetëm në vend por edhe në rajon. Rezultate të performansës pozitive si nga aspekti i operimit ashtu edhe nga ai financiar kanë vazhduar edhe në vitin përmbyllës të dekadës së parë të KOSTT dhe me meritë ka arsyetuar rolin e një prej akterëve kyç për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në Kosovë.


Duke qenë një nga funksionet bazë të kompanisë, KOSTT edhe gjatë vitit 2016 ka operuar dhe ka menaxhuar në mënyrë efikase dhe të sigurt rrjedhat e energjisë elektrike në Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës, shërbim i cili është vital për palët e kyçura në rrjetin e transmisionit, derisa ka punuar në përgatitjen e kornizës ligjore për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2016 nëpër Rrjetin Transmetues të Kosovës janë transmetuar 8.207,16 GWh energji elektrike apo 3.77 % më pak se sa në vitin paraprak, kjo për shkak të tranzitimit më të ultë të energjisë elektrike nëpër Rrjetin e Transmetues të Kosovës, krahasuar me vitin 2015.

Përmes aktiviteteve të mirëmbajtjes të planifikuara mirë, është siguruar shkallë e lartë e disponueshmërisë, besueshmërisë dhe efikasitetit të operimit, përderisa, tempoja e zhvillimit dhe avansimit të Rrjetit të Transmisionit ka vazhduar me investime të mëtutjeshme që në vitin 2016 janë realizuar në vlerë prej € 28,363,372. Kjo ka rezultuar me një rritje prej 3.71% të gjatësisë së linjave të tensionit të lartë 110 kV, dhe kapaciteteve bartëse nga 1550 MW në vitin 2015 në 1700 MW në fund të vitit 2016, si rezultat i kompletimit të një pjese të projekteve para afatit kontraktual për 1.5 gjegjësisht 4 muaj.

Rrjetit Transmetues të Kosovës i është shtuar edhe 91 km linjë e re e nivelit 400 kV apo shprehur në përqindje 48.28% rritje krahasuar me vitin paraprak. Këtu i referohem linjës ndërshtetërore Kosovë Shqipëri e cila u inaugurua në qershor të vitit 2016 në Tiranë, por për shkak të mos implementimit të Marrëveshjes për Kycje KOSTT/ENTSO-E si pasojë e obstrukcioneve të vazhdueshme nga Serbia, kjo linjë nuk është komercializuar ende. Në anën tjetër janë nënshkruar kontratat dhe kanë filluar përgatitjet për setin e ardhshëm të projekteve të cilat bashkëfinancohen me BERZH në vlerë të përgjithshme prej € 36.5 milion.

Implementimi i Marrëveshjes së Energjisë të arritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi ende nuk ka filluar që të implementohet ngjashëm sikurse edhe Marrëveshja për Kycje me ENTSO-E prandaj edhe gjatë vitit 2016 kanë vazhduar me përkushtim të theksuar angazhimet për sigurimin e pozicionit të merituar të KOSTT në mekanizmat ndërkombëtar, sfidë e cila po e përcjell KOSTT-in tashmë sa vite. Edhe pse nga aspekti

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 7 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

përgjegjësi të veta teknike dhe operative KOSTT është e përgatitur për të funksionuar si zonë/bllok rregullues, për shkak të pengesave politike që po i imponon operatori i transmisionit të Serbisë, kjo mbetet sfidë kryesore për menaxhmentin e kompanisë.

Një progres i shënuar në vitin 2016 në aspektin e integritimit në mekanizmat ndërkombëtar është fillimi i implementimit të Marrëveshjes për kompensim ndër TSO (Inter TSO Compensation) për transit të energjisë elektrike në kuadër të shteteve pjesëmarrëse në këtë mekanizëm.

KOSTT mbetet e përkushtuar për të implementuar zotimet në kuadër të procesit të Dialogut për Energji si dhe obligimet karshi Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore si dhe vazhdon me aktivitetet për përmbushjen e “masave të buta” në kuadër të procesit Western Balkans 6 Energy Connectivity Initiative.

KOSTT dhe OST e Shqipërisë, janë duke punuar në projektin për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (APE) dhe bashkimit të tregut të energjisë, në përputhje me Deklaratën e Ministrave të firmosur në mars 2016, Direktivave të Bashkimit Evropian dhe rekomandimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore (SKE). Në përkushtimin për ngritjen e cilësisë së punës dhe ekselencës së biznesit, në vitin 2016 është bërë përgatitja dhe ndërtimi i Sistemit të Integruar të Cilësisë (SIM), duke përfshi Sistemin e menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, Standardin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në punë OHSAS 18001:2007 dhe Standardin e Mbrojtjes së Mjedisit ISO 14001:2015, certifikimi për të cilat pritet të bëhet gjatë vitit 2017.

Edhe këtë vit KOSTT ka dëshmuar stabilitet financiar duke i përmbushur në kohë të gjitha obligimet financiare ndaj kontraktorëve sipas afateve kontraktuale, përfshirë dhe pagesat e obligimeve për kredi ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare, derisa është arritur që të ruhet koeficienti i likuiditetit dhe koeficientet tjerë financiar mbi caqet e përcaktuara me objektivat strategjike dhe marrëveshjet me kreditorët. Ndërsa, për të dhjetin vit radhazi Raporti i Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare është pa asnjë kualifikim.


Jam i bindur që në vitin 2017 do të marrin formë reformat e reja në sektorin e energjisë në Kosovë sipas pakos së re të ligjeve të miratuara në vitin 2016 dhe në këtë rrugëtim KOSTT do të luaj rol të rëndësishëm dhe proaktiv në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në Kosovë. Në kuadër të reformave primare, me ligjin e ri të energjisë elektrike, të drejtat e aksionarit për KOSTT ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në Raportin Vjetor që është prezantuar, ju mund të shihni një pasqyrë të përmbledhur të aktiviteteve, zhvillimeve dhe rezultateve të arritura gjatë vitit 2016 në KOSTT, të cilat kanë qenë të mundura falë përkushtimit profesional të punonjësve dhe mbështetjes nga Bordi i Drejtorëve, si dhe palët e interesit të cilët vazhdojnë të besojnë në profesionalizmin e dëshmuar të KOSTT.

Sinqerisht,

Mustafë Hasani

Kryeshef Ekzekutiv

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fape 8 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Raporti i Kryesueses së Bordit të Drejtorëve

1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit

Përbërja aktuale e Bordit të Drejtorëve të KOSTT është caktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike me vendimin 07/47 te datës 02.09.2015, ndërsa mbledhja konstituive është mbajtur me datë 25 shtator 2015. Sipas vendimit nr. 07/47 te datës 02.09.2015 Drejtorët e Bordit janë:

1. znj. Drita Konxheli-Radoniqi (Kryesuese),
2. z. Gani Jashari (anëtar),
3. z. Musa Misini (anëtar),
4. znj. Anita Cucovic (anëtare),
5. z. Afrim Prekazi (anëtarë),
6. z. Nebih Zariqi (anëtar),


Ministri i Zhvillimit Ekonomik në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike me vendimin 2402 i datës 06.10.2015, emëroi Komisionin e Auditimit, në përbërjen vijuese:

1. z. Afrim Prekazi (Kryesues),
2. znj. Anita Cucovic (anëtare),
3. z. Musa Misini (anëtar).

Ndërsa mbledhja konstituive e përbërjes së re të Komisionit të Auditimit është mbajtur me 22 tetor 2015.

Gjatë vitit 2016 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka mbajtur gjithsejtë trembëdhjete (11) mbledhje të rregullta, dhe dy (2) mbledhje të jashtëzakonshme. Bordi i Drejtorëve gjithashtu ka mbajtur edhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin.

Ndërsa Komisionit i Auditimit gjatë vitit 2016 ka mbajtur gjithsejtë njëmbëdhjete (8) mbledhje.


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Raporti për tremujorin e katërt 2015 (TM4 2015)
2	Elaborati i regjistrimit vjetor të pasurisë për vitin 2015
3	Raporti Vjetor 2015
4	Raporti për kënaqësinë e konsumatorit për vitin 2015
5	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2016
5	<u>Miratimi i Marrëveshjes për kredi me KfW Faza VI-VII</u>
5	Raportet për tremujor për vitin 2016 (TM1, TM2, TM3)
6	Rishikimi i planit të biznesit dhe buxhetit për vitin 2016
7	Miratimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare dhe Letrën e menaxhmentit për vitin 2015
8	Miratimi i planit të biznesit dhe Buxhetit për vitin 2017

Përveç çështjeve dhe vendimeve të paraqitura më lartë, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave sipas Ligjit për ndërmarrje publike në vazhdimësi kanë shqyrtuar performancën e KOSTT, dhe kanë qenë mbështetës për menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara në planin e biznesit.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për energjinë elektrike në gusht të vitit 2016 (Ligji Nr. 05/L – 085), si është përcaktuar në nenet 11, 12, 13, dhe 14 dhe në përmbushje të kërkesave të Pakos së Tretë të Bashkimit Evropian për shturjen pronësore të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, të drejtat e aksionarit për KOSTT ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës, në kuptim të kësaj, siç është përcaktuar në Nenin 14 paragrafi 15, "Dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, lidhur me kompetencën për emërimin e Bordit të Drejtorëve, ushtrimin e të drejtave të aksionarit, kompensimin e Bordit të drejtorëve dhe raportimin, dhe emërimin e Komisionit të Auditimit, nuk vlejnë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.", dhe të gjitha këto kompetenca ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, Ligji për ndërmarrjet publike vazhdon të aplikohet për të gjitha çështjet tjera të cilat ndërlidhen me veprimtarinë e KOSTT.

Prandaj, në përmbushje të obligimeve ligjore nga data 6 Gusht 2016 të drejtat e aksionarit për ndërmarrjen publike Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu – KOSTT sh.a.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës. KOSTT vazhdon të operoj si ndërmarrje publike e organizuar në formën ligjore të shoqërisë aksionare.

1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja

Drejtorët e Bordit në KOSTT në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efikasitet më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

Përbërja dhe struktura e Komisioneve të përkohshme të Bordit gjatë vitit 2016 ka qenë si në vijim.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT në mbledhjen e 76/16 me qëllim të njoftimit më të afërt me zhvillimet lidhur me fillimin e operimit të pavarur të KOSTT si Zonë Rregulluese dhe mbështetjen e menaxhmentit në arritjen e objektivave të KOSTT, ka themeluar Komisionet e përkohshme me mandat prej një viti nga data e themelimit, si në vijim.

1. Komisioni për operimin e sistemit

Drita Konxheli Radoniqi (Kryesuese)

Gani Jashari (anëtar)

Musa Misini (anëtar)

2. Komisioni për operimin e tregut

Gani Jashari (Kryesues)

Nebih Zariqi (anëtar)

Drita Konxheli Radoniqii (anëtare)

3. Komisioni për çështje ligjore dhe rregullative

Nebih Zariqi (Kryesues)

Afrim Prekazi (anëtar)


Anita Cucovic(anëtare)

Komisionet e përkohshme sipas përbërjes së lartëshënuar kanë mbajtur nga një (1) mbledhje gjatë vitit 2016.

Struktura dhe përbërja e lartëshënuar e komisioneve të përkohshme sipas vendimit të Bordit nr. 15113-II/5 nga mbledhja 68/15 ka qenë aktive gjithashtu deri me fund të muajit maj, dhe gjatë kësaj periudhe ka mbajtur një (1) mbledhje.

1.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2016 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërje si vijon:

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

znj. Drita Konxheli-Radoniqi, Kryesuese e Bordit të Drejtorëve, anëtare e Komisionit për operimin e tregut, Kryesuese e Komisionit për operimin e sistemit, me profesion ekonomiste Profesoreshë e lëndëve ekonomike në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës.

Gjithsej kompensimet bruto 2016: €14,330 + €1,700 performanca për vitin 2015.

z. Gani Jashari, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit për operimin e tregut, anëtarë i Komisionit për operimin e sistemit, me profesion fizikant, Profesor i lëndëve fizike në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Prishtinës.

Gjithsejt kompensimet 2016: € 11,988.18 +1,500 performanca për vitin 2015 .

z. Musa Misini, Drejtor i Bordit, Anëtarë i Komisionit të Auditimit, anëtarë i Komisionit për Operimin e Sistemit, me profesion inxhinier i elektros.

Gjithsejt kompensimet 2016: € 13,448.18 +€1,500 performanca për vitin 2015 .

znj. Anita Cucovic, Drejtoreshë e Bordit, anëtare e Komisionit të Auditimit, anëtare e Komisionit për Çështje Ligjore dhe Rregullative, me profesion ekonomiste.

Gjithsejt kompensimet 2016: €13,538.18 € +1,500 performanca për vitin 2015 .


z. Afrim Prekazi, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit të Auditimit, anëtarë i Komisionit për çështje ligjore dhe rregullative, me profesion jurist.

Gjithsejt kompensimet 2016: €13,988.18 + 1,500 performanca për vitin 2015..

z.Nebih Zariqi, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit për Çështje Ligjore dhe Rregullative, me profesion inxhinier.

Gjithsejt kompensimet 2016: € 11,898.18 +€1,500 performanca për vitin 2015.

Kompensimi bruto përfshinë pagesën bazë si dhe kompensimin për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit në vlerë prej €90 për mbledhje sipas vendimit të Bordit nr. 161013-II/4/1

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual

Performanca pozitive e afarizmit në KOSTT ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016, duke u karakterizuar me zhvillime të shumta.

Gjatë vitit 2016 ka vazhduar përfshirja në infrastrukturën e SCADA\EMS, e elementeve të sistemit të cilat ishin zhvilluar pas implementimit të kësaj infrastrukture. Me këtë është mundësuar avancimi në ngritjen e funksioneve operative në monitorim dhe kontroll, veçmas në operimin e sistemit në kohën reale. Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve Komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avancuara për operim të rrjetit transmetues në nivel të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe në kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektro-energjetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative.

Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive edhe më tutje mbetet e pa përfshirë pjesa veriore e Kosovës, ku për shkaqe veç të njohura të pamundësisë së qasjes së lirë fizike, ende nuk është mundësuar përfshirja në këtë paket e NS Vallaqit dhe HC Ujmanit me NS Zubin Potok.


Përmes projektit në implementim të projektit “Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS” edhe në vitin pasues do të vazhdojë përfshirja e disa nënstacione të rehabilituara dhe transformatorëve të shtuar në nënstacionet ekzistuese, të gjitha këto të implementuara pas përfundimit të projektit të SCADA\EMS & Telekom.

Megjithatë, mbetet që për asetet e NS 110/x kV të kaluara nga KEK në KOSTT, duhet të zgjerohet niveli i kontrollit dhe monitorimit deri në kufirin e ri. Kjo do të funksionalizohet hap pas hapi dhe në vazhdimësi do të përfshihen edhe ndryshimet e tjera në rrjetin transmetues për shkak të zhvillimeve të rrjetit.

Gjatë vitit 2016 infrastruktura e SCADA\EMS dhe telekomit është avancuar duke krijuar zgjerimin e mundësive të shkëmbimit të observimit të rrjeteve transmetuese fqinje në kohë reale. Në vitin 2017 mbetet që observimi në kohë reale të finalizohet edhe me TSO e Malit të Zi CGES, ndonëse pjesa e punëve që tangojnë KOSTT-in, veç ka përfunduar.

Sa i përket vendosjes së grupeve matëse komerciale në kufirin mes KOSTT dhe KEDS projekti është zhvilluar në një pjesë të madhe, ndërsa ka mbetur që deri në mesin e vitit 2017 të kompletohet vendosja e tërësishme e tyre. Tani, me vendosjen e infrastrukturës së re të grupeve matëse komerciale kemi përmirësuar në masë të konsiderueshme leximin e të dhënave kumulative të energjisë elektrike dhe saktësinë e tyre në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues, duke realizuar qasje përmes përdorimit të Fibrave Optik në pronësi të KOSTT-it, po ashtu edhe nga distanca.

Gjatë vitit 2016 ka patur kërkesa të shumta për krijimin e kushteve për implementimin e projekteve të reja dhe rehabilituese të rrjetit të transmetimit, për mirëmbajtje të planifikuar

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

dhe restauruese si dhe me kërkesë të Ministrisë së Transporteve rreth implementimit të projektit të auto udhës “Arbër Xhaferi”. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kërkesave janë përcjellur me domosdonë e shkyçjeve të objekteve elektro energjetike, me ç’rast është zvogëluar ndjeshëm siguria e furnizimit të pandërprerë, kështu që ishte sfidë e vërtet për Operatorin e Sistemit se si të bëjë koordinimin e gjithmbarshëm të këtyre shkyçjeve në aspektin brenda Kosovës si dhe në nivel regional. Përkundër këtyre rrethanave gjatë vitit 2016 është arritur që kohëzgjatja e mos furnizimit të jetë plotësisht e kontrollueshme dhe brenda parashikimeve.

Me qëllim të mbajtjes në gjendjen e duhur të asetëve, krijimin e sigurisë dhe besueshmërisë në funksionimin normal të tyre, KOSTT ka kryer punët e parashikuara operative në riparimin e pajisjeve elektroenergjetike.

Plani vjetor i mirëmbajtjes së linjave është realizuar 98%, ndërsa i nënstacioneve 96%.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera preventive, që kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operimit të transmisionit.

Mirëmbajtja e duhur dhe me kohë e pajisjeve elektroenergjetike, zhvillimi dhe zgjerimi i infrastrukturës me teknologjinë moderne, kanë krijuar një siguri të funksionimit të sistemit, si dhe janë krijuar kushtet për kujdesin më të madh ndaj ambientit që po ashtu është një nga prioritetet e KOSTT.

Performanca financiare e KOSTT-it, si edhe deri më tani, është mjaft e mirë dhe më detalisht është paraqitur në Pikën 2.3.5. të këtij Raporti.

Gjatë vitit 2016, indikatorët kyç të e performancës operative dhe financiare janë pozitive, prandaj mund të thuhet se KOSTT ka arritur caqet e parashtruara në objektivat e Planit të Biznesit për vitin 2016.


Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka vlerësuar rregullisht këta indikatorë, të cilët kanë qenë pjesë e Raporteve të rregullta tremujore, të cilat janë dorëzuar në Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike.

1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it

Gjatë kryerjes së veprimtarive të saj, KOSTT ballafaqohet edhe me risqet, të cilat në mënyrë direkte i afektojnë funksionimin.

Në mesin e ngjarjeve që kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT, vlen të përmendet Marrëveshja e firmosur për energji në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila ka qartësuar që KOSTT do të ketë përgjegjësitë për operim të pavarur gjatë vitit 2016. Kjo çështje më detalisht është shpjeguar në pikën 2.1. të këtij Raporti.

KOSTT është tanimë pjesë në Asociacionet ndërkombëtare të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit (ENTSO-E) si nënshkrues i marrëveshjes multilaterale në mekanzimin e kompensimit ndër TSO, me të cilët operojmë në mënyrë sinkrone, gjë e cila na mundëson


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

kompenzimin ne lidhje përdorimin e rrjetit te KOSTT ne lidhje me tranzitin e energjise dhe humbjet e shkakturara.

1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit gjatë vitit 2017,do të jenë:

- Fillimi i operimit të KOSTT si zonë rregulluese/bllok rregullues më vete në përputhje me rregullat e ENTSO-E;
- KOSTT ka nënshkruar Marrëveshjen për themelimin e Qendrës Rajonale për Kalkulim të kapaciteteve ndërsa në pjesën e dytë të vitit pasues pritet fillimi i operimit të kësaj qendre (RSCI). Pritet që themelues i RSCI të jenë KOSTT (Kosovë), IPTO (Greqi), MEPSO (Maqedoni), TEIAS (Turqi), ESO (Bullgari), OST (Shqipëri) dhe Transelectrica (Rumani) si observer ;
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Sekondar me OST dhe KOSTT
- Implementimi i marrëveshjeve Ndër- OST me OST-të fqinje;
- Implementimi i Mekanizmit Balancues, ndërrimit të furnizuesit si kërkesë në Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë dhe Rregullave të Tregut;
- Implementimi i masave të buta nga WB6
- Përgatitjet për të aderuar në tregun e përbashkët Kosove- Shqipëri, respektivisht në bursën e energjisë në Shqipëri
- Përgatitja e legjislacionit sekondar në përputhje me kërkesat nga Ligji i Energjisë elektrike aprovuar në Qershor 2016
- Investimet në platformat softuerike, rifreskimi i atyre ekzistuese, trajnimi dhe edukimi i stafit për përdorimin e tyre. Platformat softuerike si SCADA/EMS, SME (Sistemin për Menaxhimin e Energjisë), Kontrolli Frekuencë Fuqi-LFC, analiza e sigurisë së operimit një ditë para i njohur si DACF- (Day Ahead Congestion Forecast), Paketi softuerik për analiza para operative NEPLAN, Softuer për mbikëqyrje dhe kontroll në kohën reale, pajisjeve të TL të tipit T 5000, E-TERRA Habitat, do të mundësojnë dhe lehtësojnë kryerjen e aktiviteteve të të gjitha palëve pjesëmarrëse në tregun e energjisë, për të siguruar operim më eficient të sistemit të energjisë elektrike;
- Vazhdimi i investimeve në rrjetin e transmisionit për të arritur standarde të larta të shërbimeve ndaj klientëve dhe ngritja e efikasitetit të afarizmit financiar;
- Zgjerimi dhe eksplorimi maksimal i infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese që më saktësisht konsiston në:

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 15 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rjetit transmetues nga Qendra Nationale Dispečerike Kryesore dhe Emergjente;
2. Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS dhe i pajisjeve e fushave të instaluar me projekte të ndryshme në RTU në NS 110 kV;
3. Krijimi i kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me OST-të fqinje në kohën reale dhe shkëmbimi i informacioneve me Qendrën Koordinative Swissgrid me seli në Zvicër.
4. Ndërlidhja e domenit kostt_ost.com SME (Sistemin për Menaxhimin e Energjisë), kostt.com. AMR dhe zgjerimi i infrastrukturës së tij në nënstacione për nevojat e mbikëqyrjes së pajisjeve digjitale (mbrojtjet rele, IED, BCU dhe SCS) për nevojat e Operatorit të Sistemit dhe Transmetimit.

Në aspektin e operimit, është i gatshëm implementimi i projektit të “Kontrollit Frekuence-Fuqi” në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë, i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshojë regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në tri variante, por që fillimisht do të aplikohet versioni i parë:

1. Operimi si dy zona/Bloqe Rregulluese të veçanta me shkëmbim të shërbimeve ndihmëse,
2. Operimi me dy zona të ndara por në një Bllok rregullues me Shqipërinë,
3. Operimi në një zonë të përbashkët në faza të mëvonshme.


Edhe gjatë vitit 2017, KOSTT do të vazhdojë aktivitetet që lidhen me liberalizimin e Tregut të Energjisë elektrike në Kosovë. Aktivitetet e zhvilluara ishin në përputhje me objektivat dhe kërkesat e qeverisë rreth liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, kërkesat që dalin nga legjislacioni primar i sektorit të energjisë; kërkesat që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Direktivat e Komisionit Evropian.

Gatë vitit 2017 pritet që Tregu i energjisë elektrike në Kosovë të operojë si zonë e pavarur tregtare . Në këtë mënyrë , Operatori i Tregut do ta operojë tregun e energjisë elektrike në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar si një zonë tregtare në vetë.

Në aspektin e zhvillimit të tregut, do vazhdohet angazhimi rreth projektit për krijimin e një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri.

Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurt me energji elektrike KOSTT, ZRRrE, ERE dhe OST kanë diskutuar dhe analizuar idenë e bashkimit të dy tregjeve në një treg të përbashkët (një zonë tregtare). Tregu i përbashkët do të jepte sinjale të duhura për investime në kapacitete gjeneruese të reja dhe llojin tyre, për investime në rjetin transmetues dhe të shpërndarjes, si dhe nga tregu i përbashkët do të përfitonin konsumatorët nga të dy vendet .

Tregu i përbashkët Kosovë- Shqipëri, gjithashtu do të mundësonte hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe do të krijonte kushte për një treg konkurrues.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Themelimi i një tregu të përbashkët për të gjitha afatet kohore është në harmoni me objektivat e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë si dhe iniciativës WB 6, e që mund të konsiderohet si hap drejt integritimit në tregun rajonal të EJL.

KOSTT-i do të vazhdojë të punojë me të gjitha kapacitetet e veta që si Operator i Tregut dhe i Sistemit, të sigurojë që të jetë plotësisht i integruar në të gjitha komponentët e tregut rajonal, të cilat aktualisht janë duke u zhvilluar. Në veçanti KOSTT-i do të:

- Përcjellë zhvillimet në rajon rreth tregut të energjisë elektrike;
- Përbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë;
- Jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut;
- Bashkëpunojë me Projekt Grupin për KOSTT (PG TSO KOSTT) të themeluar nga ENTSO-E, që të monitorojë përbushjen e standardeve të ENTSO- E nga ana e KOSTT;
- Vendosë marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të e Evropës Kontinentale;
- Zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal;
- Të jetë pjesëmarrës aktiv në aktivizimin e operimit të RSCI në Selanik;
- Kontribuojë në punën e SEE CAO (Coordinated Auction Office) dhe të angazhohet që kapacitetet interkonektive të KOSTT të alokohen nga SEE CAO, ku KOSTT është një nga themeluesit dhe aksionarët;
- Kontribuoj në fillimin e punës operative të RSC


Në korrik të vitit 2016 kanë hy në fuqi Ligjet e reja të Energjisë të cilat janë aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, respektivisht: Ligji për Energji (Ligji Nr. 05/L – 081), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L – 085) dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L – 084). Në bazë të Ligjeve të reja të Energjisë të cilat janë në harmoni me Direktivat e BE-së respektivisht me Pakon e Tretë të BE-së për Energji dhe në bazë të legjislacionit sekondar të zhvilluar dhe të aprovuar nga ZRrE, KOSTT duhet të zhvilloj legjislacionit sekondar përkatës.

Sipas legjislacionit në fuqi në fillim të vitit 2017 nga ZRrE do të iniciohet procesi i azhurnimeve vjetore për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) dhe tarifat/ngarkesat e energjisë elektrike, të cilat pritet të hyjnë në fuqi me 1 Prill 2017. KOSTT do të bëjë përgatitjen e të gjitha të dhënave dhe arsyeshmërive për aplikacionin për të Hyrat Maksimale të Lejuara për vitin 2017.

Në vitin 2017 pritet që ZRrE të inicioj shqyrtimin tarifor për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën tarifore 2018-2022. KOSTT do të përgatit të dhënat dhe arsyeshmëritë sipas kërkesave nga ZRrE dhe sipas afateve kohore të përcaktuara nga ZRrE.

Ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve të domosdoshme do të vazhdojë në mënyrë që të sigurohet furnizim stabil dhe i sigurt me energji elektrike dhe ngritjen e performancës së tyre në nivelin e pranueshëm teknik..

KOSTT me aktivitetet e ndërmarrja që nga kalimi i aseteve nga KEK në KOSTT, ka arritur që të ketë një siguri shumë më të lartë të operimit të pjesës së stabilimenteve 110/x dhe

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

mund të thuhet se performanca e arritur është mjaftë e kënaqshme. Këtë e dëshmon numri i rënieve dhe intervenimeve, të cilat nga viti në vit kanë qenë në rënie dhe tani është arritur që të minimizohet numri i tyre, përkundër vjetërsisë dhe eksploatimit të tyre. Njëkohësisht, është duke u investuar në rehabilitimin e këtyre NS-ve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre. Sepse qëllimi kryesor i mirëmbajtjes është që të sigurojë një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe sigurisë në sistemin elektroenergetik. Kështu, përmes aktiviteteve të duhura në sistem, është arritur të krijohet një stabilitet i qëndrueshëm në funksionimin normal të sistemit. Duke iu falënderuar kësaj, si dhe investimeve të shumta, **KOSTT ka kaluar nga mirëmbajtja emergjente në mirëmbajtje preventive.**

KOSTT krijon Planin e mirëmbajtjes për vitin 2017 bazuar në Rregulloren e Mirëmbajtjes sipas së cilës definohej të gjithë hapat e nevojshëm që duhet ndërmarrë në të gjithë rrjetin transmetues, në mënyrë që të jenë funksionale dhe të garantojnë performancë të mjaftueshme për operim


Prioriteti i KOSTT-it mbetet që të avancojë sistemin e mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta, të cilat aplikohen në sistemet e avancuara, duke u bazuar në Rregulloren dhe gjendjen e pajisjeve, në mënyrë që të kursethet koha dhe kostojat e mirëmbajtjes.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së përkohshme për kyçje KOSTT-ENTSO-E, pritet që KOSTT të fillojë operimin e pavarur të sistemit përfshirë këtu: menaxhimi komercial i kongjestionëve në linjat interkonektive të Kosovës, alokimin e kapaciteteve interkonektive si dhe do të realizohen të hyrat nga transiti i energjisë elektrike nëpër rrjetin transmetues të Kosovës.

Modi ri i operimit përfshin kryesisht aktivitetet që ndërlidhen me bashkëpunimin e OST-ve të interkonektuara, me qëllim të operimit të sigurt të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimet e respektimit të rregullave të ENTSO-E. Për të filluar operimin si bllok rregullues, në vitin 2017, në KOSTT duhet të arrihen këto objektiva:

- Ngritja e kapacitetit të stafit të Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut për të performuar me punët e reja që ndërlidhen me operimin e KOSTT si bllok rregullues dhe implementimin e marrëveshjeve operative me ENTSO-E dhe OST-të fqinje, në veçanti me:
 - analizën e sigurisë së punës së sistemit një ditë para dhe gjatë ditës;
 - nominimin e programit ndërkufitar dhe programeve të palëve tregtare një ditë para në formë të automatizuar përmes softuerëve adekuatë;
 - krijimin e modelit të sistemit të Kosovës për qëllim të llogaritjeve të parametrave të sigurisë së operimit, veprimi adekuat në rrethana emergjente, përpunimi i planit të ri mbrojtës, alokimin e kapacitetit dhe llogaritja e kongjestionëve.

Aktivitetet e mësipërme KOSTT do t'i bashkërendis me konsulencën "Eliagrid", e financuar nga EBRD. Ky projekt quhet "Capacity Building Assistance", dhe ka filluar më 24 prill 2016, ndërsa përfundon më 15 gusht 2018.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>	

- Investimet në zhvillimin e infrastrukturës që mundësojnë proceset e mësipërme, si:
 - Qasja në “electronic highway –EH”
 - Implementimi dhe operimi i Sistemit të TI të Tregut për të bërë në mënyrë automatike procesimin dhe shkëmbimin e të dhënave me OST-të tjera sipas kërkesave të ENSTO-E;
 - Dërgimi i të dhënave në kohë reale në Qendrën Koordinative të Evropës Kontinentale-Swissgrid, të specifikuara nga PG TSO KOSTT;
 - Dërgimi i të dhënave dhe monitorimi i një pjese të sistemit transmetues për çështje të sigurisë së operimit të sistemit në KOSTT dhe të sistemeve tjera: OST, MEPSO, CGES dhe EMS sipas kërkesave të ENTSO-E;
 - Shkëmbimi i të dhënave me OST-të tjera për qëllim të nominimit të programit dhe barazimit përfundimtar duke përfshirë edhe themelimin e Iniciativës Rajonale për Siguri të Koordinuar, RSCI;
 - Shkëmbimi i të dhënave me Bllloqet Rregulluese fqinje dhe Qendrën Koordinative;
 - Marrëveshjet për alokimin e kapaciteteve në baza vjetore, mujore, ditore me OST-të fqinje.

1.7. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendin

Kapitali themeltar i KOSTT-it në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 (*njëzetepesëmijë*) Euro dhe është i ndarë në 25.000 aksione me vlerë nominale 1 Euro secili. Kapitali i Shoqërisë është deklaruar dhe paguar tërësisht në momentin e themelimit të KOSTT-it .


Aksionari i vetëm i KOSTT-it është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital është dhënë në pikën 2.3.5. të këtij Raporti.

1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit

Në përputhje me Planin e Biznesit 2016 dhe Planin Zhvillimor të Transmisionit, investimet e planifikuara kryesisht kanë qenë në infrastrukturë për transmetimin e energjisë elektrike dhe janë përqendruar në:

- Përforsimet në rrjetin e transmisionit;
- Përkrahja e ngarkesës/nënstacionet e reja 110/10(20)kV ;
- Ri-vitalizimi i rrjetit të transmisionit;
- Projektet përkrahëse të operimit të sistemit të transmisionit (menaxhim, monitorim, matje dhe kontroll);
- Në përkrahje të zhvillimit dhe ndërtimit të autostradës Kosovë – Maqedoni; zhvendosja e shtyllave 400kV.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Zhvillimi dhe implementimi i projekteve gjatë vitit 2016 kryesisht ka qenë në realizimin e projekteve të filluara në vitet paraprake, të financuara nga KOSTT, KfW/KE dhe BERZH.


KOSTT gjatë vitit 2016, ka qenë i fokusuar në plotësimin e obligimeve dhe detyrave në lidhje me implementimin e projekteve që janë renditur në vijim:

I. Menaxhimi i projekteve, që kanë përfunduar në vitin 2016 dhe janë në afat garantues;

1. Paket Projekti "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, faza IV &V" të financuar nga KfW/KE dhe KOSTT:
 - NS 110/35/10 kV Peja 1 – stabilimentet GIS (5 fusha 110 kV, prej gjithsejtë 7 fushave 110 kV, janë kompletuar 5.0 muaj para afatit kontraktual të kompletimit) – LOT1;
 - Fushat transformatorike 400/110 kV në NS Peja 3 (1.5 muaj para afatit kontraktual të kompletimit) – LOT1;
 - Furnizimi dhe instalimi i transformatorit të dytë energjetik TR2, 300 MVA në NS 400/110 kV, Peja 3 (1.5 muaj para afatit kontraktual të kompletimit) – LOT2;
 - Fushat transformatorike 400/110 kV në NS Ferizaji 2 (1.0 muaj para afatit kontraktual të kompletimit) – LOT1; Furnizimi dhe instalimi i transformatorit të dytë energjetik TR2, 300 MVA në NS 400/110 kV – Ferizaj 2 (1.0 muaj para afatit kontraktual të kompletimit) – LOT2;
 - Ndërtimi i linjës së dyfishtë 110kV, NS Peja 1 – NS Peja 3 (1.5 muaj para afatit kontraktual të kompletimit) – LOT3
2. Rehabilitimi i stabilimenteve të tensionit të lartë në NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3;
3. Revitalizimi i nënstacioneve NS 110kV, ana 35kV në NS Gjakova 1;
4. Instalimi i transformatorit të tretë në NS 110/10(20) kV Prishtina 2;
5. Instalimi i TR2 në NS 110/10kV Berivojcë dhe Viti,
6. Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Prizreni 2.

II. Menaxhimi i projekteve, që kanë filluar me implementim në vitet paraprake dhe janë në vazhdimësi:

7. Shërbimet Konsulente për mbikëqyrjen e punëve implementuese: "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit faza IV &V",
8. Paket Projekti "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit faza IV &V":
 - a. LOT 1: Nënstacionet (Rehabilitimi i ndërprerësve në NS 220/110kV Prishtina 4, Instalimi i Grupeve Matëse në pikat interkonektive, 2 fushat 110 kV të GIS, në NS Peja 1);
 - b. LOT 3: Linjat transmetuese (Rehabilitimi i linjës 110kV, NS Peja 2 – NS Deçan);
 - c. LOT 4: Rehabilitimi i 19 nënstacioneve;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 20 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

9. Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike,
10. Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH,
11. Instalimi i TR 2 ne NS 110/10(20) - Skenderaj dhe instalimi i TR në NS Burim.


III. Menaxhimi i projekteve, për të cilat janë nënshkruar kontratat dhe kanë filluar me punë implementuese gjatë vitit 2016:


Në vitin 2016 janë nënshkruar kontratat për projektet, që financohen nga BERZH/KOSTT:

1. Shërbimet konsulente për Menaxhimin e implementimin e Projektit e Zhvillimi i Transmisionit të Kosovës;
2. Shërbimet konsulente për ngritje të kapaciteteve;
3. **LOT 1** – Nënstationet GIS: [110/10(20) kV – NS Prishtina 6 dhe 110 kV HIS në NS Prishtina 4], [110/10(20) kV – NS Mitrovica 2], [110/10(20) kV - NS Theranda] dhe [220/10(20) kV – NS Drenasi 2];
4. **LOT 2** – Transformatorët e fuqisë: 40MVA 2x40 MVA, në NS Prishtina 6, 2x40 MVA në NS Mitrovica 2 dhe 2x40 MVA në NS Drenasi 2;
5. **LOT 3** – Linjat transmetuese [linja 110 kV e njëfishtë, NS Rahoveci – NS Theranda], [linja 110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike, NS Fushe Kosova], [linja 220 kV e dyfishtë Drenasi 2], [linja 110 kV e dyfishtë NS Mitrovica2] dhe [linja 110 kV e dyfishtë kabllorike, NS Prishtina 6 – NS Prishtina 4].

Në total gjatë vitit 2016, janë investuar: 28,363,372 EUR, të ndara në burimet e financimit :


Grant	Kredi	Kostt
6,723,649	10,722,825	12,101,898



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Në vitin 2016 bazuar në Marrëveshjen e Kçqjes në mes të KOSTT dhe KelKos, për kyçjen e hidrogjeneratorëve në Rrjetin e Transmisionit, investitori KelKos ka transferuar Asetet 110kV në KOSTT, si Asete të Transmisionit, në vlerë prej 708,835.65 EUR.

Po ashtu gjatë vitit 2016 ka pasur disa aplikacione të reja për kyçje. Aplikacionet për kyçje kan qenë kryesisht Gjenerator me Erë, me kapacitet prej 103,5MW, për të cilët është përgatitur Oferta dhe Draft Marrëveshja e Kçqjes edhe pritet finalizimi gjatë tremujorit të parë të 2017.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>	

2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

2.1. Arritjet kryesore

Edhe gjatë vitit 2016, KOSTT ka dëshmuar edhe një herë se është një organizatë e qëndrueshme dhe efektive, duke vazhduar me trendin e performimit pozitiv dhe duke zhvilluar një mori aktivitetesh që nga themelimi e deri më sot.

Një nga detyrat kryesore të KOSTT dhe në përputhje me objektivat e saj strategjike, mbetet edhe më tutje ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit. Në këtë drejtim, trendi i performimit pozitiv ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016.


KOSTT ka zhvilluar infrastrukturën e operimit të sistemit dhe tregut, janë zhvilluar dhe shumë nga kodet e domosdoshme teknike dhe rregullat e tregut dhe do të vazhdojnë të zhvillohen edhe në të ardhmen. Megjithatë, tani është me rëndësi për KOSTT-in që të përgatitet për sfidat e reja me të cilat do të përballet në të ardhmen. Një vend të rëndësishëm në këtë drejtim zënë zhvillimet e tregut në Kosovë dhe rajon dhe një ndër objektivat e saj strategjike është edhe integrimi rajonal dhe arritja sa më e shpejtë e operimit si Zonë Rregulluese dhe anëtarësimit në ENTSO-E.

Në korrik të vitit 2016 është energjizuar me sukses linja 400kV Kosovë – Shipëri, ndërsa përpos rasteve për qëllime testimesh, linja nuk është komercializuar. Arsyet për këtë janë të lidhura me mos fillimin e implementimit të marrëveshjes së kyçjes mes KOSTT dhe ENTSO-E.

Me qëllim të zhblokimit të Marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E janë zhvilluar aktivitete me faktorët relevant të Kosovës si dhe me strukturat ndërkombëtare të lidhura me këto procese, në rend të parë me ENTSO-E dhe Sekretariatit e Energjisë. Përkundër përpjekjeve të pareshtura në këtë drejtim nuk është arritur që të startohet me implementimin e punës si Bllok rregullues siç parashihet në CA mes KOSTT dhe ENTSO-E. Shkaku i kësaj situatë është i natyrës politike, konkretisht për shkak të pengesave politike që ka bërë Serbia përmes TSO e tyre EMS-i, përkundër faktit se nga aspekti teknik nuk kishte pengesa

Gjatë vitit 2016 KOSTT kishte startuar si pjesë integrale e mekanizmit të ITC për qëllime të tranistit. Në këtë çështje ka patur kooperim me trupat relevante të këtij mekanizmi dhe KOSTT-it në shkëmbimin e informacioneve të nevojshme.

Poashtu, gjatë vitit 2016 janë mbajtur raporte pune me PG-TSO-KOSTT me ç'rast ne u jemi përgjigjur kërkesave të tyre për raporet periodike të ndryshme.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Busheti</i>	

Gjatë vitit 2016 është realizuar përfaqësim i barabartë i KOSTT-it në Grupin Punues Rajonal të Mirëmbajtjes së kapaciteteve Interkonektive dhe kapaciteteve me ndikim të drejtpërdrejt në transmetim për Rajonin e Evropës Jug-Lindore, në kuadër të ENTSO-E.

Ky Grup Punues, ashtu siç e parasheh Doracaku i Operimit të ENTSO-E, Politika 4 (Planifikimi i Koordinuar Operativ), pos takimeve vjetore të organizuara nga Operatorët e Sistemeve Rajonale në principin e rotacionit, mbanë edhe Telekonferencën Javore WOPT ku raportohet për punën e Sistemit për javën e shkuar dhe planin për javën e ardhshme. Ky GP për Rajonin e EJM ka 12 anëtarë.

Përfaqësuesit e KOSTT-it vitin e kaluar 2016 kanë marr pjesë në punimet e këtij Grupi Punues në konferencën vjetore të mbajtur në Shkup, nën organizimin e MEPSO(Maqedoni) në nëntor të vitit 2016, si anëtarë të barabartë. Në konferencën e mbajtur në Shkup është harmonizuar Plani vjetor i ndërprerjeve të kapaciteteve Interkonektive dhe atyre të brendshme me ndikim në Interkoneksion për vitin 2017.


Implementimi i suksesshëm i mirëmbajtjes dhe projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT, në radhë të parë, në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit dhe mirëmbajtjen preventive, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Gjatë këtij viti është realizuar 98% e planit vjetor të mirëmbajtjes së linjave, 96% e mirëmbajtjes së nënstacioneve, si dhe janë zhvilluar aktiviteteve tjera të domosdoshme për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm operativ dhe të sigurisë së sistemit elektroenergetik.

Me qëllim të mirëmbajtjes sa më efektive, shfrytëzojmë Rregulloren e Mirëmbajtjes e cila për bazë ka metodologjitë më të avancuara të qasjes në stabilimente duke marrë parasysh teknologjinë e përdorur si dhe afatet e duhura kohore për mirëmbajtje dhe shqyrtime të pajisjeve elektrike. Përmes kësaj synohet që oraret dhe aktivitetet në pajisje, të jenë sa më racionale duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve. Në këtë mënyrë do të kursehet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

Përkushtimi i KOSTT-it, për arritjen e objektivit të kompanisë siç është përgjegjësia në aspektin e sigurisë dhe mjedisit, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016, duke përmbyllur vitin:

- pa asnjë aksident apo situatë emergjente shëndetësore apo mjedisore.
- me përgatitje të procesit për certifikim me standardet ISO 14001 dhe OHSAS 18001 për të garantuar një ambiente të sigurt pune dhe të përgjegjshëm ndaj mjedisit,
- me kujdesin për informim dhe trajnim të punëtorëve nga Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit sipas programeve trajnuese në të cilat janë përfshirë 321 punëtorë apo gjithsej 658 orë trajnim,
- me nënshkrimin e Marrëveshjes për Koordinimin e Sigurisë për Aktivitete Pune në Kufi mes KOSTT dhe TC Kosova A dhe përgatitjen e

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

marrëveshjeve për nënshkrim me Feronikelin, Sharrcemin dhe TC Kosova B si përdorues të kyçur drejtpërdrejt në rrjetin transmetues

Opinionin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2015 është pa asnjë kualifikim, edhe atë, për të dhjetën herë radhazi, duke filluar qysh nga viti 2006. Kjo e arritur dëshmon më së miri punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve. Veç kësaj, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.

Sipas kërkesave ligjore, është përgatitur dhe është dërguar në ZRrE Raporti i Monitorimi të Kodit të Rrjetit në të cilin janë paraqitur rezultatet dhe lidhur me implementimin e dispozitave nga Kodi i Rrjetit.

Gjatë vitit 2016, nga ZRrE është iniciuar procesi i monitorimit të realizimit të shpenzimeve operative dhe të shpenzimeve kapitale. KOSTT ka përgatitur dhe i ka dërguar me kohe në ZRrE të gjitha të dhënat dhe dokumentet e kërkuara.


Me datë 3 qershor, KOSTT dhe KEDS kanë nënshkruar marrëveshjen për shfrytëzimin e lokacioneve ekzistuese të nënstacioneve të KEDS për ndërtimin e aseteve të reja të transmisionit (stabilimentet GIS dhe transformatorët energjetik 2x40 MVA me infrastrukturën tjetër përcjellëse), për projektet e KOSTT të bashkë financuara me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH): NS 220/10(20) kV- Drenasi 2, NS 110/10(20) kV -Prishtina 6, NS 110/10(20) kV - Mitrovica 2 dhe NS 110/10(20) kV- Fushë Kosova. Objekt i kësaj marrëveshje është vendosja e të drejtës për shfrytëzim dhe pronësia për (a) ndërtimin e nënstacioneve që kanë për qëllim përkrahjen e ngarkesës në hapësirat që janë në pronësi të KEDS si dhe (b) ndërtimi/instalimi i kapaciteteve të rrjetit të shpërndarjes në hapësirat e nënstacioneve 220kV dhe 110 kV të cilat janë në pronësi të KOSTT.

Gjatë vitit 2016, në kuadër të përgatitjes së dokumenteve janë përfunduar dhe dorëzuar në ZRrE dokumentet si në vijim:

- Plani Zhvillimor i Transmisionit 2017-2026
- Adekuacia e Gjenerimit 2017-2026
- Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026

Po ashtu, kanë përfunduar studimet specifike në kuadër të kërkesave që dalin nga ENTSO-E, si dhe analizat teknike të kyçjeve, si:

- Analiza teknike e Kyçjes së Parkut Energjetik me Erë SELAC 1,2 dhe 3 me kapacitet 103.5 MW
- Analiza teknike e Kyçjes së Parkut Energjetik me Erë KOZNICA me kapacitet 34.5 MW
- Analiza teknike e Kyçjes së NS Malisheva në rrjetin e transmisionit


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Në kuadër të aktiviteteve në grupet rajonale, vlen të përmendet Iniciativa **SECI**, sponsorizuar nga USAID dhe menaxhuar nga USEA. Ky grup përfshinë të gjitha vendet e Evropës Juglindore duke përfshirë edhe Turqinë, ku KOSTT-i paraqitet si palë e barabartë dhe merr pjesë në modelimin e rrjetit të SEE të Kosovës, e cila inkorporohet në modelin rajonal . Këto modele të punuara në programin softuerik PSS/E përfshijnë horizontin kohor planifikues 2020, 2025 dhe 2030, në të cilën OST-të planifikojnë zhvillimin e rrjetit, gjenerimit dhe ngarkesës.

KOSTT në mënyrë aktive ka marrë pjesë në përgatitjen e draft **Strategjisë së Energjisë 2017-2026** të Republikës së Kosovës, me ç ‘rast janë kryer të gjitha analizat e bilancit dhe adekuacisë së gjenerimit, bazuar në skenarët e zhvillimit të gjenerimit dhe ngarkesës/kërkesës.

KOSTT ka dhënë kontribut të veçantë në analizën e Ligjit për Energjinë Elektrike dhe obligimet/përgjegjësitë që dalin nga ky Ligj. Poashtu, është përpiluar procedura për ndërrimin e furnizuesit, të cilën ZRrE në harmoni me Ligjin e Energjisë Elektrike, e ka miratuar si procedurë të vetën.

Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2016, janë paraqitur më detalisht në pikën 2.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2016.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


2.2. Ngjarjet kryesore të vitit

- **KOSTT pjesë e mekanizmit-ITC (Inter TSO Compensation)**-Për herë të parë që nga themelimi i KOSTT, nga data 1 janar 2016 ka filluar implementimi me sukses i Marrëveshjes për kompensim ndër TSO (Inter TSO Compensation) për transit të energjisë elektrike në kuadër të shteteve pjesëmarrëse në këtë mekanizëm. Nga kjo datë KOSTT është anëtare në këtë mekanizëm dhe kompenzohet për energjinë elektrike që kalon tranzit nëpër Rrjetin Transmetues të Kosovës.

- **Forumi i Nivelit të Lartë “Siguria e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë”** - KOSTT mori pjesë në Forumin e Nivelit të Lartë “Siguria e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë”, organizuar në Prishtinë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe përkrahur nga projekti REPOWER (USAID). Me këtë rast, para audiencës u prezantua roli i KOSTT në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës, gjendjen aktuale të Rrjetit të Transmisionit dhe planet për zhvillim të mëtutjeshëm, rëndësinë e zhvillimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë si dhe zhvillimeve të fundit në raport me asociacionin evropian të OST-ve (ENTSO-E). Në Forum, është diskutuar edhe për përparësitë që sjell tregu i përbashkët i energjisë elektrike me Shqipërinë në raport me stabilitetin e furnizimit dhe operimit të Sistemit Elektroenergjetik gjë e cila përveq tjerash vlerësohet të ketë ndikim edhe në uljen e çmimeve të energjisë elektrike.

- **KOSTT nënshkruan marrëveshje me KEDS për shfrytëzimin e pronave me qëllim të implementimit të projekteve të transmisionit** - Me 3 qershor 2016 në Prishtinë, KOSTT dhe KEDS nënshkruan marrëveshjen për shfrytëzimin e lokacioneve ekzistuese të nënstacioneve të KEDS për ndërtimin e asetëve të reja të transmisionit (stabilimentet GIS dhe transformatorët energjetik 2x40 MVA me infrastrukturen tjetër përcjellëse), për projektet e KOSTT të bashkëfinancuara me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH): NS 220/10(20) kV- Drenasi 2, NS 110/10(20) kV -Prishtina 6, NS 110/10(20) kV - Mitrovica 2 dhe NS 110/10(20) kV-Fushë Kosova. Ky është hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm drejt nënshkrimit të Marrëveshjeve për Kyçje në Rrjetin Transmetues në mes të KEDS dhe KOSTT për objektet e lartpërmendura, si dhe fillimit të realizimit të këtyre projekteve të KOSTT që kanë për qëllim furnizimin më cilësor të konsumatorëve me energji elektrike në këto qytete.

- **Kosova dhe Shqipëria të vendosura për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike**- më 30 mars 2016, Ministri i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës z.Blerand Stavileci dhe Ministri i Industrisë dhe Energjetikës së Shqipërisë z.Damjan Gjijnuri firmosën një deklaratë të përbashkët përmes së cilës morën një sërë angazhimesh në kuadër të nismës për ndërtimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike. Me Deklaratën e Ministrave përcaktohet që, KOSTT dhe OST Shqipëri do të bashkëpunojnë në krijimin dhe operimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (APE) në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


(SKE), si dhe do të lehtësojnë integrimin e Bursës Shqiptare të Energjisë me Bursat e Energjisë në vendet fqinje duke i vënë në dispozicion kapacitetet e interkoneksionit. Palët do të bashkëpunojnë në krijimin e një zone të vetme tregtare si dhe do të punojnë për të optimizuar kapacitetet transmetuese.

- **U prezantua Raporti i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e Linjës së dyfishtë 110kV që lidhë NS 400/110kV Peja 3 me NS 110/35/10 kV Peja 1** - Gjatë debatit publik të organizuar, u prezantuan ndikimet e mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike si dhe u ofruan rekomandime në lidhje me implementimin e projektit nga ky aspekt. Në anën tjetër, ekspertet e fushës së energjetikës të KOSTT sh.a, folën para të pranishmëve mbi rëndësinë që ka realizimi i këtij projekti për sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit për rajonin e Pejës dhe Istogut.

- **Nënshkruhen kontratat për Projektin “Zhvillimi i Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Kosovës”, bashkëfinancuar me BERZH** -Më 20 Qershor 2016, KOSTT nënshkroi kontratat për implementimin e disa projekteve që bashkë-financohen me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Zhvillimin e Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës. Investimi në implementimin e këtyre projekteve do mundësohet përmes kredisë komerciale afatgjate, që KOSTT sh.a e ka siguruar nga BERZH në vlerë prej € 30 milion, € 4.5 milion nga buxheti i KOSTT për investime kapitale si dhe granti nga BERZH në vlerë prej € 2 milion. Ky investim njëherit përbën kredinë e parë të BERZH pa garancion shtetëror për një ndërmarrje publike në Kosovë”. Nga momenti i fillimit të punimeve, implementimi i projekteve parashihet që të përfundojë në afat prej 24 muajsh.

- **Inaugurohet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri** -Pas 28 vitesh që kur u ndërtua linja e parë dhe e vetme interkonektive gjer më tani në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, me 28 qershor 2016 në Nënstacionin Tërana 2, në praninë e delegacioneve të larta të Qeverive të të dyja vendeve u inaugurua linja ndërshtetërore 400 kV Kosovë-Shqipëri. Linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri ka një gjatësi totale prej 241.1 km, nga të cilat 151.1 km shtrihen në territorin e Shqipërisë dhe 90 km shtrihen në territorin e Kosovës. Punimet për ndërtimin e linjës në pjesën e Kosovës kanë përfunduar në dhjetor 2015, ndërsa në pjesën e Shqipërisë në qershor 2016. Me këtë, tani më Sistemi Transmetues i Kosovës është i lidhur me nivelin 400 kV me të gjitha shtetet fqinje, gjë e cila e forcon edhe më shumë pozitën e Sistemit Elektroenergetik të Kosovës si një njeje e rëndësishme në rajon.

- **Kuvendi i Kosovës miraton ligjet e reja të energjisë** - Për të garantuar furnizim të sigurtë të konsumatorëve me energji elektrike dhe me qëllim të organizimit të sektorit të energjisë në përputhje me kërkesat e Pakos së Tretë të energjisë të Bashkimit Evropian, Kuvendi i Kosovës në muajin qershor 2016 ka miratuar, ndërsa në muajin korrik janë shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës tri ligjet e reja të sektorit të energjisë: **-Ligji për Energjinë** (nr.05/L-081) - Fushëveprimi i këtij ligji përfshin


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

përcaktimin e kornizës rregullative për zhvillimin e politikave dhe strategjive, rolin e akterëve në zbatimin e tyre për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe efikas me energji. Ky ligj përfshin energjinë elektrike, energjinë termike, gazin natyror dhe energjinë nga burimet e ripërtërishme; **-Ligji për Energjinë Elektrike** (nr.05/ L-085) - Fushëveprimi i këtij ligji përfshin rregullat e përbashkëta për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin dhe tregun e organizuar të energjisë elektrike, si pjesë e tregut rajonal dhe evropian të energjisë elektrike, si dhe përcakton rregullat që kanë të bëjnë me qasjen e palëve në rrjet, obligimet për shërbime publike, të drejtat e konsumatorëve dhe kushtet e konkurrencës dhe **-Ligjin për Rregullatorin e Energjisë** (nr.05-L-084) - që rregullon kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Nëntë (9) muaj pas hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve të gjitha aktet, vendimet, rregullat dhe dokumentet tjera të miratuara apo të shpallura sipas Ligjeve paraprake (për Energjinë, Energjinë Elektrike dhe Rregullatorin e Energjisë) duhet të harmonizohen me këto ligje.

- **10 vite nga themelimi i KOSTT** – Me 1 korrik 2016, janë mbushur 10 vjet që nga themelimi i KOSTT si Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës. Kjo erdhi si rezultat i ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë, bazuar në kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore. Gjatë 10 viteve të funksionimit të KOSTT si kompani publike, janë shënuar të arritura të shumta duke ndërtuar kështu imazh të një kompanie publike të suksesshme, jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Në periudhën 10 vjeçare janë arritur suksese të shumta në të gjitha dimensionet, janë ndërtuar më se 267 km linja të reja të tensionit të lartë, kapacitetet bartëse janë rritur për 83% apo 1700 MW krahasuar me 930 MW në vitin 2006. Gjithashtu, falë investimeve të vazhdueshme, humbjet në rrjetin e transmisionit janë zvogëluar për 58% që njëherit përbëjnë humbjet më të ulëta në rajon. KOSTT mbetet i përkushtuar në ruajtjen dhe krijimin e vlerave të reja në sistemin elektroenergjetik dhe nga ky pozicion të jap kontributin në rritjen ekonomike dhe mirëqenien shoqërore të Kosovës.

- **Vlerësohet performansa si dhe roli qenësor i KOSTT në funksionimin e Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës** - Në vizitën të cilën e realizuan me 20 korrik 2016 në KOSTT, Kryeministri i Kosovës z.Isa Mustafa dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik z.Blerand Stavileci ku u pritën nga bordi i KOSTT në krye me Kryesuesen znj.Drita Konxheli-Radoniqi dhe menxhmenti i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, u vlerësua lart performansa e kompanisë si dhe roli qenësor i KOSTT në funksionimin e gjithmbarshëm të Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës.


-**Të Dhënat e Transparencës** - Sipas obligimeve nga Rregullorja e Bashkimit Evropian (BE) nr.543/2013, KOSTT në muajin korrik 2016 ka filluar publikimin e parashikimit dhe realizimin në kohë reale të ngarkesës dhe gjenerimit në Sistemin Transmetues të Republikës së Kosovës si dhe planifikimi i shkyçjeve. “Të dhënat e Transparencës për herë të parë në Kosovë janë publike dhe të gjithë të interesuarit mund ti gjejnë në ballinën e webfaqes së KOSTT www.kostt.com me titull: Ngarkesa dhe Gjenerimi në Sistemin Transmetues.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 29 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


- **Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik vlerëson lart rolin e KOSTT dhe shpreh mbështetjen për të vazhduar me performansën pozitive** - Anëtarë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të Kuvendit të Kosovës në krye me Kryetarin e Komisionit z.Muhamet Mustafa vizituan KOSTT-in. Kryesuesja e Bordit të drejtorëve znj.Drita Konxheli-Radoniqi duke falënderuar deputetët e Kuvendit të Kosovës për vizitën e tyre të parë, theksoi rëndësinë që ka KOSTT për Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës, ndërmarrje e cila cilësohet si një nga më të suksesshmet dhe e cila shquhet për performansën pozitive si teknike ashtu dhe financiare, duke ofruar shërbime kualitative për palët e kyçura në Rrjetin Transmetues të Kosovës. Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani, i njoftoi të pranishmit në lidhje me funksionimin dhe operimin e Sistemit Transmetues të Kosovës, punën që po zhvillohet në KOSTT. Me këtë rast, Kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik z.Muhamet Mustafa vlerësoi lart rolin e KOSTT dhe inkurajoi të KOSTT-in për të vazhduar me performansën pozitive edhe më tutje. Kjo vizitë e Komisionit për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të Kuvendit të Kosovës në KOSTT u realizua në dritë të miratimit të ligjit të ri për energjinë elektrike, sipas të cilit të drejtat e aksionarit për KOSTT do të ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës

- **KOSTT nikoqir i takimeve regjionale të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Evropës Juglindore** - Me 13 dhe 14 tetor 2016 nën organizimin e KOSTT sh.a në Prishtinë, u mbajtën punimet e takimit të 22të të Bordit të Drejtorëve të Zyrës për Alokim të Kapaciteteve Interkonektive për Evropën Juglindore (SEE CAO) si dhe takimit të 21të të Grupit rajonal të vendeve të Evropës jug-lindore të rrjetit evropian të OST-ve (RG SEE). KOSTT është një nga themeluesit e Zyrës rajonale për alokim të koordinuar të kapaciteteve transmetuese interkonektive – SEE CAO me seli në Podgoricë. Themelimi i kësaj Zyre është një hap drejt krijimit të tregut të përbashkët rajonal dhe integritimit në tregun unik Evropian, dhe në anën tjetër, ofron Kosovën në përmbushjen e obligimeve të marra në kuadër të Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë për EJJL dhe procesit të integritimit në BE. Ndërsa RG SEE është grup regjional në ombrellen e Komitetit të tregut të rrjetit evropian të OST-ve të, i cili merret me çështjet e tregut në EJJL.

- **KOSTT merr pjesë në Konferencën Rajonale të ENTSO-E “Pjesëza e fundit e mozaikut: Integrimi i Evropës Juglindore në Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike”** - Me datë 2 dhe 3 nëntor 2016 në Selanik (Greqi), menaxhmenti i KOSTT sh.a mori pjesë në Konferencën Rajonale për Evropën Juglindore të Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (ENTSO-E). Në kuadër të konferencës, zv.Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Kadri Kadriu prezantoi para të pranishmëve rolin dhe ndikimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në ngritjen e sigurisë së operimit të sistemit rajonal, mundësitë e krijimit të tregut të përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri si dhe integritimit të tij më tutje në rajon. Me këtë rast, z.Kadriu gjithashtu foli edhe për pasojat e mos implementimit të Marrëveshjes për Kyçe KOSTT-ENTSO-E dhe ndikimin në mos-funksionalizimin e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri, shqetësimin për mos

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 30 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

vënien në operim të së cilës e shprehu edhe Ministri i Energjisë së Shqipërisë z. Damian Gjoknuri, gjatë fjalës së tij. Në suaza të konferencës u mbajt edhe takimi i nivelit të lartë të drejtorëve të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (OST) të EJL ku u diskutua për objektivat dhe sfidat për funksionalizimin e tregut të energjisë elektrike në Evropën Juglindore. Në këtë takim KOSTT paraqiti progresin e arritur deri më tani si dhe sfidat me të cilat po përballlet si pasojë e mos implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT – ENTSO-E, me të cilën parashihet që KOSTT të filloj operimin si zonë/bllok i pavaruar kontrollues.


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 31 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

3.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

2.3.1 Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2016


Muajt MWh	Janar-Dhjetor 2016		
	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) TC Kosova A	1 983 439	2 143 341	108.06
(2) TC Kosova B	3 685 460	3 592 945	97.49
(3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B)			
(4) HC Ujmani	95 000	96 869	101.97
(5) HC Lumbardhi	63 124	85 954	136.17
* (6) = 1+2+3+4+5 Prodhimi në hyrje të transmisionit	5 827 023	5 919 109	101.58
(7) Devijimi	0	3 825	0.00
(8) Eksporti	701 384	1 121 195	159.85
(9) Importi	541 320	632 289	116.81
(10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim	5 666 959	5 426 378	95.75
(11) Distribucioni	4 549 946	4 582 564	100.72
(12) Ferronikeli	639 473	211 183	33.02
(13) Sharri	64 837	72 041	111.11
(14) Trepça	25 855	24 115	93.27
(15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK	121 000	128 777	106.43
(16) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)	151 930	287 240	189.06
(17) = 11+12+13+14+15+16 Kërkesa neto	5 553 041	5 305 920	95.55
(18) Humbjet në transmission	113 918	120 458	105.74
(19) =17+18 Kërkesa gjithsej	5 666 959	5 426 378	95.75


Disa prej të dhënave kryesore të tabelës së mësipërme si kërkesa (konsumi) dhe prodhimi neto i Kosovës, importi dhe humbjet teknike në rrjetin transmetues të Kosovës janë ilustruar edhe në diagramin në vijim:



Në diagramin e mëposhtëm në GWh, është paraqitur figurativisht bilanci i shpërndarjes së gjithë energjisë elektrike që hynë në rrjetin transmetues të Kosovës drejt destinacioneve për periudhën Janar-Dhjetor 2016.

Diagrami i balancës së realizuar elektroenergjetike Janar-Dhjetor 2016 (GWh)



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat konkrete të indikatorëve teknik të performancës së sistemit për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2016, të cilët janë tregues se si është implementuar plani i aprovuar i bilancit vjetor 2016, në krahasim me të njëjtën periudhë kohore të vitit paraprak 2015.

Nga rezultatet e fituara shihet se koha mesatare e mosfurnizimit të konsumatorëve ka qenë më e lartë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015.

- (T3) Koha mesatare e ndërprerjes ka qenë më e lartë, gjë që tregon se gjatë implementimit të projekteve për zhvillimin dhe rehabilitimin e rrjetit të transmisionit, janë bërë shkyçje të shumta, ku në disa raste është pamundësuar furnizimi i konsumatorëve me energji elektrike. Një sasi e energjisë së pafurnizuar ka qenë edhe për shkak të KEDS-KESCO (rreth 17%).
- (T4) Ka qenë një ankesë për tension e cila është eliminuar shpejt.
- (T6) Vlera mesatare e devijimeve ka qenë në import (tërheqje nga sistemi) 7,07 më e lartë se në periudhën e njëjtë 2015, ndërsa eksport (shtyerje në sistem) 4,32% më e ultë se sa periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.
- (T7) Humbje teknike më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak për 9,49%.
-

Nr	Indikator				Caku	Komenti
		Janar-Dhjetor 2015	Janar-Dhjetor 2016	2016/2015(%)		
T1	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)					Do të aplikohet kur KOSTT fillon të funksionojë si zonë rregulluese
T2	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC					Do të aplikohet kur KOSTT fillon të funksionojë si zonë rregulluese
T3	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/periudhen e raportimit)	178.9	181.2	101.27	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhen aktuale)/(AIT për periudhen e kaluar) < 1	AIT ka qenë më e lartë gjatë periudhes Janar-Dhjetor 2016, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015 për 1,27%, për shkak të shkyçjeve të shumta

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

							dhe konfigurimit të rrjetit gjatë implementimit të projekteve.
T4	Numri i ankesave për tension		0	1		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhen e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë.
T5	Numri i ankesave për matje		0	1	0		
T6	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	20.18	21.61	107.07	30MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla.
		Eksport	22.96	21.97	95.68	30MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar	
T7	Humbjet në transmision (GWh)		110.02	120.46	109.49		Humbjet e energjisë në transmision kanë qenë për 9.49 % më të larta, për shkak të shkyçjeve dhe konfigurimit të rrjetit gjatë implementimit të projekteve, si dhe ngarkesës më të lartë të sistemit.

AATC-Average Available Transmission Capacity


MATC-Maximum Available Transmission Capacity

$AIT=(8760*60*ENS)/TE$

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pa furnizuar


TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar (Energjia që hyn në transmision) është energjia e cila hyn në transmision nga prodhimi i gjeneratorëve (Prodhimi në prag të transmisionit) dhe importeve si rrjedha fizike nga linjat interkonektive (import flow).

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 36 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit


Nr	Indikatori	Niveli i tensionit	Mesatarja 5 vjeçare (2009-2015)	2016	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV		Janar - Dhjetor 2016	2016/ mesataren (%)	<= 1	
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.11	0	0	>1	Probleme ne izolatorin e LP179/3
		220	0.86	0.43	0.497685		
		110	0.95	0.98	1.033755		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0.45	0	0	>1	Këputja e përçusit fazor ne LP293/1 dhe LP205/1, si dhe problemet me izolator në LP179/3
		220	2.46	31	12.59139		
		110	26.95	6.97	0.258646		
T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0	0	<1	
		220	0.00	0	0		
		110	0.00	0	0		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	0.00	0	0	> 1	NS Lipjani Intervenim ne ndërprerësin e TR -2 NS Rahoveci Intervenim pas rënies se punës së TR -1 dhe TR -2 pas lidhjes së shkurtër në ndërprerësin 35 kV
		220/110	0.02	0	0		
		110/35/10	26.92	28.4	1.054978		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 37 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0.00	0	0	< 1	
		220/110	0.60	0	0		
		110/35/10	8.52	8.07	0.947554		
T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.00	0	0	>1	NS Lipjani Intervenim ne ndërprerësin e TR -2 NS Rahoveci Intervenim pas rënies se punës së TR -1 dhe TR -2 pas Lidhjes së shkurtër në ndërprerësin 35 kV
		220/110	0.00	0	0		
		110/35/10	8.58	10.33	1.203495		
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.00	0	0	<1	
		220	0.66	0	0		
		110	1.61	0	0		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	0.85	0	0	<1	
		220	0.40	0	0		
		110	2.61	0	0		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0.00	0	0	<1	
		220	0.00	0	0		
		110	0.00	0	0		
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	2.00	0	0	>1	
		220	0.55	2.63	4.747292		
		110	0.24	0.59	2.5		
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	0.60	0	0	>1	Prishja nuk ka ndikuar në mos dërgim të energjisë gjatë kësaj periudhe, pasi prishja ka
		220	0.76	2.5	3.289474		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 38 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		110	1.28	3.2	2.5		ndodhur ne sistemin e mbrojtjes së zbarrave dhe është eliminuar gjatë punës nën tension
T12	Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0	0	<1	
		220	0.00	0	0		
		110	145.44	0	0		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 39 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.4. Operimi i tregut

2.3.4.1 Aktivitetet operative

Gjate këtij viti procesi i skedulimit (nominimi i transaksioneve të energjisë elektrike të palëve në tregun e energjisë elektrike është kryer me sukses dhe pa vërejtje nga palët në tregun e energjisë elektrike. Nominimi i programeve të palëve në tregun e energjisë është kryer përmes platformës SMT (sistemi për menaxhimin e tregut). Pas harmonizimit të programeve, palëve në treg, ZRRë dhe MZHE u janë dërguar raportet mbi Programet e Aprovuara për ditën në vijim.

Duke filluar nga Tetori 2016 me udhëzimin nga ZRRë ka filluar:

- nominimi ndaras i furnizimit për konsumator të rregulluar dhe konsumator të pa rregulluar për KESCO
- nominimin e humbjeve në transmision nga Operatori i Sistemit
- nominimin e energjisë që KEK do ta marr nga rrjeti i transmisionit për shpenzime vetanake (KEK-LOMAG)
- Gjithashtu KESCO ka marrë përsipër të bëjë edhe nominimin për KELKOS pas vërejtjeve të cilat i kemi dërguar në ZRRë lidhur me shkeljet të Nenit 11 të Rregullave të Tregut nga KELKOS palë kjo e regjistruar në treg.

Pas aktiviteteve në D-1 të procesit të Skedulimit dhe procesit të tregutit fizik në ditën D në ditën D+1 fillon procesi i barazimit përfundimtar energjetik dhe financiar për detyrimet e palëve në tregun e energjisë elektrike.

Është kryer me sukses Grumbullimi i të gjitha të dhënave energjetike meritore për faturim që përdoren si madhësi hyrëse për procesin e barazimit përfundimtar si: prodhimi, konsumi, importi dhe eksporti i energjisë elektrike në kufirin me Operatorin e Sistemit të Transmisionit.

Llogaritja e Detyrimeve direkte për shfrytëzim të rrjetit, detyrimeve për operim të sistemit dhe detyrimeve për operim të tregut dhe faturimi i tyre për palët përkatëse është kryer me kohë dhe nuk ka pasur asnjë kontest nga palët:

Pas shumë takimeve të Grupit Teknik për definimin e pikave matëse në kufirin KOSTT - KEK - KEDS – KESCO është bërë identifikimi i pikave matëse ndërmjet KEK dhe KESCO që furnizohen nga rrjeti i brendshëm i KEK-ut. Të dhënat nga këto pika matëse janë të domosdoshme për llogaritjet e obligimeve për jo-balancave dhe obligimet e palëve e për çdo orë (periodë të barazimit përfundimtar).

Është përpiluar dhe prezantuar KEK dhe KESCO metodologjia për llogaritjen e energjisë së matur (alokuar) për KEK dhe KESCO për çdo periudhë të barazimit përfundimtar j

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Bazuar në udhëzuesin për furnizim me energji elektrike me tarifa të parregulluara të ZRrE-së nga muaji Tetor 2016 ka filluar faturimi i veçantë për KESCO i detyrimeve për furnizim të konsumatorëve të parregulluar dhe konsumatorëve të rregulluar.

Nga 1 janari i vitit 2016, është kryer me sukses implementimi i Marrëveshjes për kompensim ndër TSO për Transit të energjisë elektrike në kuadër të shteteve pjesëmarrëse në mekanizmin për kompensim ndër TSO.

Në afate të rregullta (një herë në muaj) janë përgatitur dhe dërguar tek Administratori (Swissgrid) të dhënat e barazimit përfundimtar të interkonektorëve. Llogaritjet e bëra janë konfirmuar nga Administratori dhe është bërë faturimi i transitit për shtetet të cilat kanë qenë debituese në KOSTT dhe janë procesuar faturat për shtetet që kanë qenë kredituese.

Bazuar në Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit të Jo-balancit dhe udhëzuesin për furnizim me energji elektrike me tarifa të parregulluara të ZRrE-së si dhe në dispozitat e Rregullave të Tregut, nga 1 Tetori 2016 është realizuar me sukses barazimi përfundimtar i detyrimeve për jo-balance i mekanizmit balancues, pa efekt financiar, për Palët Relevante në Treg (KEK, KESCO (konsumatorët e rregulluar dhe të parregulluar), HC Ujmani, KelKos dhe Humbjet në transmision.

Gjatë vitit 2016 në tregun e Kosovës janë regjistruar gjithsej gjashtë palë të reja në treg. Po ashtu, janë regjistruar një numër i konsiderueshëm i sistemeve matëse në kufirin ndarës (35/10 kV) ndërmjet KOSTT dhe palëve tjera.

Është bërë automatizimi i llogaritjeve të barazimit përfundimtar të jo-balanceve të palëve relevante përmes MS Excel (VBA) për çdo palë të barazimit përfundimtar.

Bazuar në procedurën për llogaritjen e garancionit financiar është përpiluar modeli për llogaritjen preliminare të garancionit financiar për palët relevante, e aplikueshme në rast të mos pagesës së jo-balanceve.

Është realizuar me sukses testimi i barazimit përfundimtar (“Accountingut”) me CGES (sipas kërkesës së CGES).

2.3.4.2 Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral dhe i rregulluar ku mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar. Feronikeli furnizohet nga KESCO me çmim të pa rregulluar në nivelin 220kV.


Madhësia e tregut e paraqitur në diagramet më poshtë shprehet si raport i energjisë së konsumuar në nivelin 220kV me konsumin e përgjithshëm në Kosovë..

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2015 në këtë periudhë të vitit 2016 kemi rritje të humbjeve nga 110.011MWh në 120.458MWh.


Tranziti i energjisë elektike në periudhën Janar-Dhjetor’16 në rrjetin e KOSTT ka qenë 1.737.207MWh gjegjësisht 21.01% e rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues.

Konsumi tarifor në nivelin me pakicë në periudhën Janar-Dhjetor’16, e furnizuar nga rrjeti 110kV, ka qenë 4.764.674 MWh apo 95.76% e konsumit total ta dalë nga rrjeti transmetues që ishte 4.975.857 MWh.

Tregu i rregulluar dhe pa-rregulluar




Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues



Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmission

Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jo tarifor



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 42 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet

BILANCI I GJENDJES			
12/31/2016			
	Note	Vit (2015) (EUR 000)	Vit (2016) EUR (EUR 000)
PASURITE JO QARKULLUESE			
Palujtshmerite, impiantet dhe pajimet	4	142,070	146,941
Investimet ne vijim	5	14,835	27,808
		156,905	174,749
PASURITE QARKULLUESE			
Stoqet,pjeset rezerve dhe veglat	6	3,345	3,499
Arketueshmerite dhe kerkesat tjera	7	5,396	8,145
Huate,avanset dhe depozitat	8	6,624	5,133
Tatimi ne te hyra		2	539
Paraja ne arke dhe bilanci bankar	9	26,436	22,947
		41,803	40,263
		198,708	215,012
KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT			
Kapitali aksionar	10	25	25
Kapitali i trashëguar	11	53,323	53,325
Fitimi I mbajtur		23,085	29,908
Fitimi per periudhe		6,823	6,821
		83,256	90,079
DETYRIMET JO KURENTE			
Grantet e pranuar neto	12	88,153	84,140
DETYRIMET KURENTE			
pagueshmerite dhe obligimet tjera	13	10,471	15,537
Kredi afat gjate	14	16,828	25,256
		115,452	124,933
		198,708	215,012
Zyrtari kryesor financiar		Kryeshefi Ekzekutiv	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 43 nga 94</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

PASQYRA E TË ARDHURAVE

	Realizimi Janar-Djetor 2015	Buxheti Janar-Dhjetor 2016	Realizimi Janar-Dhjetor 2016	% realizimit ndaj buxhetit
Të hyrat nga rrjeti 220 /400 kV	556	587	587	100%
Të hyrat nga rrjeti 110 kV	14,670	15,213	15,213	100%
Të hyrat nga sistemi i operimit	8,300	7,094	6,723	95%
Të hyrat nga operatori i tregut	335	446	416	93%
Gjithësejt të hyrat nga tarifat	23,861	23,341	22,939	98%
Të hyrat tjera operative	39	30	125	417%
Të hyrat nga interesi	284	296	330	112%
Të hyrat nga tranziti		500	335	67%
Të hyrat e shtyera	6,407	7,340	7,096	97%
Gjithësejt të hyrat	30,591	31,507	30,826	98%
Shpenzimet operative	12,102	15,972	11,684	73%
1 Mirëmbajtja	612	931	753	81%
2 Shpenzimet e stafit	5,103	5,178	5,040	97%
2.1 Pagat	4,528	4,504	4,367	97%
2.2. Kontrata në vepër	98	120	126	105%
2.3 Përformanca e planifikuar	477	554	546	99%
3 Shpenzimet tjera operative	1,720	1,824	1,423	78%
4 Rregullimi sekondar	-	3,500	-	0%
5 Humbjet në bartje	3,076	3,724	3,916	105%
6 Shpenzimet e interesit	-	415	390	94%
7 Shpenzimet e tranzitit		400	164	41%
8 Shpenzimi i tatimit në fitim dhe Tvsh-së	1,592	-	-	
Fitimi para amortizimit	18,489	15,535	19,141	
Amortizimi	10,405	12,422	12,321	99%
Gjithësejt shpenzimet (operative+ amortizimi)	22,507	28,394	24,005	
Fitimi para tatimit	8,084	3,113	6,821	
Tatimi në fitim	1,261			
Neto Fitimi / Humbja	6,823	3,113	6,821	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 44 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2016

PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE			
2016-01-01 / 2016-12-31			
	Not e	Viti Paraprak (2015)	Viti Tanishëm (2016)
		(EUR 000)	EUR (EUR 000)
RRJEDHA E PARASE NGA AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi gjate vitit		8,084	6,821
Pershtatjet per:			
Provizionimi I stoqeve			
Te hyrat nga interesi		(284)	(330)
Shlyerja e mjeteve themelore.		-	
Amortizimi I palujtshmerive,impianteve dhe pajisjeve	4	10,405	12,320
Te hyrat e shtyera		(6,407)	(6,407)
Rrjedha operative e parase para levizjeve ne kapitalin punues		11,798	12,404
Rritje e Stoqeve nga Grantet			
Rritje ne stoqe,pjese rezerve dhe vegla		(741)	(154)
Rrritje ne Arketueshmeri dhe kerkesa tjera		(2,718)	(2,748)
Rritje ne hua,avanse dhe depozites		985	954
Rritje ne pagueshmeri dhe obligime tjera		(433)	(5,066)
Gjenerimi i parase nga aktivitetet operative		8,891	5,390
Pagesa e tatimit ne te hyra			
Paraja neto nga aktivitetet operative		8,891	5,390
RRJEDHA E PARASE NGA AKTIVITETET INVESTIVE			
Grantet e pranuar		13.617	9.943
Kredia e pranuar		16.829	11.218
Intersi i pranuar		284	330
Blerja e aseteteve te reja		(36,696)	(30,370)
Paraja neto nga aktivitetet investive		(5,966)	(8,879)
Rritja neto e parase dhe ekuivalenteve te parase		2,925	(3,489)
Paraja dhe ekuivalentet e parase me (2015-12-31)		23,511	26,436
Paraja dhe ekuivalentet e parase me (2016-12-31)		26,436	22,947

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 45 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>	

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2016

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL				
Perfundimisht 01.01.2016-31.12.2016.				
	Kapitali aksionar	Kapitali i trasheguar	Fitimi i mbajtur	Total
	----- EUR -----			
Kapitali aksionar ne para	25			25
kontributet tjera jo para		53,325		53,325
Fitimi per periudhen e mehereshme			29,908	29,908
Fitimi I muajve te mehershem				-
Shtesat e share premium				
Fitimi per periudhe			6,821	6,821
Bilanci me DATA	25	53,325	36,729	90,079

Informacionet për vitin financiar 2016

Të hyrat operative gjatë vitit 2016 kanë qenë 30,826, 000 euro dhe janë për 1% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet operative (shpenzimet operative dhe shpenzimet e amortizimit) janë realizuar në vlerën prej 24,005,000 euro dhe janë për 6.7 % më të larta në krahasim me vitin paraprak.

Të hyrat e realizuara nga tarifa janë në vlerë prej 22,939,000 euro dhe janë për 3.9% më të ulta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa të hyrat tjera operative në vlerë prej 7,887,000 euro janë për 17.2% më të larta se në vitin 2015.


Fitimi para tatimit për vitin 2016 është në vlerë 6,821,000 euro.

Pasuritë jo qarkulluese janë në vlerën prej 174,749,000 euro, pasuritë qarkulluese 40,263,000 euro, ndërsa gjithsej pasuria e KOSTT sh.a. në vitin 2016 është 215,012,000 euro.

Kapitali aksionar dhe rezervat janë në vlerën prej 90,079.000 euro, detyrimet afatgjata (të hyrat e shtyra) 84,140,000 euro dhe detyrimet afatshkurtra 15,537,000 euro.

Nga të dhënat e prezantuara, shihet se pasuria e KOSTT është financuar nga:

- 41.9% kapitali i aksionarit
- 39.1% grante qeveritare dhe grante tjera
- 7.2% detyrime afatshkurtra
- 11.7% kreditë afatgjate jashtë vendit

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 46 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare

Në vazhdim, janë dhënë IKP-të që paraqesin performancën financiare të KOSTT-it gjatë vitit 2016

Treguesit	I-XII 2015	I-XII 2016	Shpjegimet
T1. Fitimi operativ marginal = Fitimi neto /gjithsejtë të hyrat	0.22	0.22	Qëllimi është që të jetë mbi zero . Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese. Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj. Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.
T2. Treguesi i likuiditetit = kapitali punues/detyrimet qarkulluese	3.15	2.10	Përcakton aftësinë e kompanisë për të paguar detyrimet e saj afat shkurta. Sa më e lartë është vlera e këtij treguesi, aq më e lartë është siguria që kompania posedon mjete për të mbuluar borxhet afatshkurta. Treguesi duhet të jetë më i madh se 1 .
T3. Treguesi i qarkullimit të kërkesave =kërkesat *365 ditë/të hyrat	39	35	Ky tregues është i matshëm në baza vjetore Caku: ≤ 90 ditë
T4. Treguesi i efektit te kapitalit te investuar (ROCE) = fitimi neto/mesatarja e kapitalit të investuar mesatarja e kapitalit të investuar = Total asetet- obligimet	3.98	3.92	Tregon eficientësinë dhe profitabilitetin e investimeve kapitale të kompanisë. Sa më i madh është fitimi operativ marginal, aq më i madh është ky tregues. Caku: > 0
T5. Giring = kreditë afatgjate jashtë vendit/kapitali*100	22.02	30.33	Ky tregues tregon raportin mes borxhit total afatgjatë dhe kapitalit. Është një tregues për të matë levën financiare, duke demonstruar shkallën në të cilën aktivitetet e një kompanie janë financuar nga fondet e kompanisë kundrejt fondeve të kreditorit. Caku: <60%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 47 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2.4. Progresi me Planin e Biznesit

KOSTT sh.a, është Ndërmarrje Publike që vepron si Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës dhe zë një vend të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë dhe drejtohet me ligjin korporativ të emërtuar si Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Roli i KOSTT-it është që të operojë sistemin e transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Përgjegjësitë e KOSTT-it janë përcaktuar me ligjet e energjisë (Ligjin për Energji, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë) dhe në licenca. Po ashtu, përgjegjësi e KOSTT-it është edhe bashkëpunimi me operatorët e sistemit të Evropës Kontinentale në marrëveshjet rajonale dhe më gjerë.

Misioni

Misioni i KOSTT-it është që:

- Të ofrojë shërbime cilësore duke implementuar teknikat dhe teknologjitë më të avancuara për zhvillimin e sistemit të transmisionit;
- Të sigurojë transparencë dhe jo diskriminim mes shfrytëzuesve të sistemit të transmisionit në një treg konkurrues të energjisë elektrike;
- Të promovojë qëndrimet e kompanisë në nivel rajonal dhe evropian;

Në përputhje të plotë me vizionin e vet, KOSTT synon që “Të jetë kompani financiarisht e qëndrueshme dhe fitimprurëse, e cila siguron transmetimin e sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptim social dhe mjedisor dhe e integruar me rrjetet dhe institucionet evropiane të transmisionit të energjisë elektrike“.

Për të realizuar synimet e përcaktuara, janë vendosur edhe objektivat strategjike, të cilat para së gjithash kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT-i është një organizatë efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Objektivat e vendosura të KOSTT për vitin 2016 janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit transmetues të energjisë elektrike;
2. Avancimi i mirëmbajtjes dhe operimit të sistemit të transmisionit;
3. Siguria dhe besueshmëria e sistemit të transmisionit;
4. Krijimi i kushteve për operimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në pajtim me zhvillimet e pritura;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 48 nga 94</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

5. Qëndrueshmëria financiare;
6. Pjesëmarrja aktive në proceset e zhvillimit të tregut rajonal (të përfitojë nga zhvillimi rajonal dhe të kontribuojë në të);
7. Zhvillimi i tregut të përbashkët Kosovë – Shqipëri;
8. Anëtarësimin në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
9. Funkcionalizimi i zonës rregulluese/bllokut rregullues të KOSTT dhe implementimi i aranzhmaneve që ndërlidhen me operimin e sistemit dhe tregut në interkoneksion;
10. Vendosja e marrëdhënieve efektive me palët e interesit;
11. Të jetë punëdhënës atraktiv, që investon në zhvillimin profesional të punonjësve të vet;
12. Të jetë kompani e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor;
13. Të krijojë një ambient të sigurt pune;
14. Optimizimi i punës së sistemit dhe eficiency.

Objektivat e lartcekura do të shërbejnë për analizimin e të arriturave të KOSTT gjatë vitit 2016, respektivisht, për implementimin e Planit të Biznesit për vitin referues.

Gjatë vitit 2016, janë realizuar 98% të aktiviteteve të mirëmbajtjes së linjave dhe 96% të mirëmbajtjes së nënstacioneve. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshirë në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i linjave dhe nënstacioneve, remontet e linjave dhe transformatorëve, shqyrtimi i rregullt transformatorëve dhe i fushave, termografia, analiza kimike e prezencës së gazrave (DGA), shqyrtimet e mbrojtjeve rele, zëvendësimi i pjesëve dhe pajisjeve të domosdoshme në sistem, si dhe aktiviteteve të planifikuara të mirëmbajtjes si pjesë e zhvillimit të projekteve dhe komisionimit të tyre.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera preventive si: realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve, analizimi i prishjeve, specifikimet teknike, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për vlerësimin e ofertave, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për pranim teknik, pjesëmarrja në implementimin e projekteve të ndryshme në KOSTT etj. Të gjitha këto aktivitete kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operimit të transmisionit, kjo ka kërkuar një menaxhim dhe optimizim në maksimum të ekipeve në teren.

KOSTT do të vazhdojë edhe më ngritjen profesionale të stafit të mirëmbajtjes për teknologjinë e re në nënstacione dhe situatën e re të krijuar në linja, pas investimeve në linja të dyfishta si dhe kompletimin më tutje të pajisjeve të nevojshme.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 49 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Edhe gjatë vitit 2016, Banka Botërore ka ofruar një pako mbështetje konsultuese për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) të Kosovës dhe KOSTT-in, në kuadër të një granti nga Ndërmarrja Këshilluese për Infrastrukturë Publike-Private (PPIAF). Kjo mbështetje ka për qëllim lehtësimin e shkëmbimit më efektiv të infrastrukturës në mes të Sektorit të energjisë dhe atij të telekomunikacionit, ku përfshihen dokumentet dhe prezantimet, të përgatitura nga konsulenca Deloitte, si:

1. Operacionalizimi i shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës telekomunikuese të KOSTT-it
2. Hartimi i modelit të kostos dhe analiza sensitive për vlerësimin e kostove për shërbime të infrastrukturës telekomunikuese të KOSTT-it,

KOSTT pas shqyrtimit të mundësive tekniko ekonomike dhe legale për të filluar ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës telekomunikuese me përkrahjen nga Banka Botërore përmes konsulentëve internacionalë, ka tentuar të filloj komercializimin e fijeve optike. Gjatë vitit 2016 kishte shumë kontakte me palët e interesit dhe është punuar drejt finalizimit të përmbylljes së kontratave me kompani private që kanë shprehur interesim për huazim të kapaciteteve optike. Edhe pse ishte planifikuar që ky aktivitet të përfundoj brenda vitit 2016 kjo nuk u arrit dhe mbetet që të vazhdohet finalizimi në vitin pasues.

Nga aspekti i sistemeve SCADA/RTU janë bërë një varg ndërhyrjesh në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemeve të SCADA-ve ekzistuese si ndërrimin e HMI-ve, monitorëve, BCU-ve, përfshirjen e të dhënave të reja në SCADA lokale në pajtim me llojet e pajisjeve primare të zëvendësuar. Është bërë edhe testimi periodik i funksionalitetit të Qendrës Emergjente Dispečerike, i cili ka rezultuar me sukses.

Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, të cilat janë dhënë në vijim:

- Testimi i sistemit të shpërndarjes së ATC KOSTT - OST;
- Shtimi i RTU NS Fierza dhe testimi në sistemin SCADA/EMS;
- Pjesëmarrja në shtimin e NS Palaj, NS Prishtina 7 dhe NS Gjilani5 në SCADA/EMS si dhe Tr3 në NS Prishtina 2, Tr3 në RTU NS Prizren1, Tr3 në RTU te NS Ferizaj 1;
- Konfigurimi, testimi dhe futja në funksion të Gateway-ave të ri në NS Prizreni3 dhe NS Gjakova 2 dhe mundësimi i integriteteve të RTU-ve të rikonfiguruar në SCADA/EMS ne KCS dhe EKCS;
- Adaptimi i Outage Schedule për përcjelljen e Çkyçjeve në formë elektronike;
- Rregullimi i infrastrukturës së domenit kostt_ost.com për shfrytëzimin e sigurt të Advance Web faqes për përdorim të gjerë nga shfrytëzuesit e ndryshëm;
- Rregullimi i harduerit të Operimit të tregut për inkorporimin e kërkesave të reja të ndërlidhjes me platformën e RMC-së;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 50 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

- Pjesëmarrja në SAT për projektet e realizuara, si në : NS Gjilani1, NS Berivojce, NS Vitia, NS Podujeva, NS Prishtina 4, NS Prishtina 2, NS Prishtina 3, NS Vushtrria 2, NS Prishtina 7, NS Peja 2, NS Peja 3 dhe NS Peja 1;
- Korrigjimi i parametrave të rrjetit me qëllim të akordimit të state estimatorit me SCADA/EMS dhe mundësimin të analizave kontingjente në sistemin SCADA/EMS;
- Revidimi i dizajneve të ndryshme teknike në kuadër të projekteve të implementuara, dërgimi i zgjidhjeve adekuate teknike dhe mbikëqyrja e implementimit të tyre si ne : NS Peja 1, NS Ferizaj 2, NS Peja 3, NS Theranda dhe NS Skenderaj;
- Mirëmbajtja e rregullt dhe preventive e pajisjeve të SCADA/EMS në QED si dhe të atyre RTU sipas planit të mirëmbajtjes;
- Sigurimi i funksionalitetit të plotë i Qendrës Nacionale Dispeçerike Emergjente (rezervë) ;
- Sigurimi i funksionalitetit të interkonektimit me fibër optik me TSO-në e Maqedonisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë, për realizimin e komunikimeve inter-TSO;
- Funksionalizimi i plotë i qendrës për menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të infrastrukturës telekomunikuese NMS (Network Management System), kryesore në QND dhe asaj rezervë në QNDE, si dhe i radio sistemit telekomunikues;
- Testimi i LFC në mes të Kosovës dhe Shqipërisë;
- Me ndihmën e inter-fejseve (ndërlidhjeve) TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, është mundësuar integrimi HVM në rrjetet lokale të KOSTT, duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (GSM) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre,
- Me ndihmën e inter-fejseve TCP/IP, rrjeteve ethernet dhe centralit telefonik IP, është mundësuar gjithashtu integrimi i të gjitha objekteve elektroenergjetike në rrjetin lokal telefonik të KOSTT – VOIP (Voice over IP), duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (PTK) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre,
- Montimi dhe vurja në operim normal i RMC/backup së re
- Testimi periodik i njehsorëve dhe verifikimi i klasës së saktësisë të tyre,
- Përshtatja e sistemeve matëse me Kodin e Matjeve,
- Mirëmbajtja dhe leximi i të dhënave të matura për barazim përfundimtar nga njehsorët në Qendrën për lexim nga distanca(RMC-AMR), si dhe
- Administrimi dhe Operimi në RMC (Remote Metering Center), llogaritja dhe analiza e humbjeve teknike në transmision.

Investimet e realizuar në Rrjetin e transmisionit gjatë vitit 2016 kanë ndikuar në arritjen e objektivave të KOSTT përmes rritjes së sigurisë në sistemit Elektroenergjetik , plotësimin e kushteve teknike sipas ENTSO – E etj.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 51 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Statusi i projekteve kapitale për vitin 2016:

- 1) Shërbimet konsulente dhe Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1, financuar nga KfW (donacion) dhe KOSTT (kredi);
Pas përfundimit garantues me datën 22.12.2017 është lëshuar Certifikata Finale e Pranimit
- 2) Shërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV Fusha e TL dhe LFC - LOT 2 financuar nga KfW (donacion) dhe KOSTT (kredi);
Pas përfundimit garantues me datën 22.12.2017 është lëshuar Certifikata Finale e Pranimit
- 3) Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806, drejtimi NS Gjakova 1 – NS Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
Statusi i projektit: Projektit i ka skaduar edhe afati garantues;
- 4) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2, LOT 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it
Gjatë Q3 2016 projekti ka përfunduar dhe është në afatin garantues njëvjeçar;
- 5) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në dhe Prizreni 3 Lot 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
Gjatë Q3 2016 projekti ka përfunduar dhe është në afatin garantues njëvjeçar;
- 6) Revitalizimi i Nënstacioneve NS 110 kV, ana 35 kV (NS Gjakova 1)
Statusi i projektit: Projektit i ka skaduar edhe afati garantues;
- 7) Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Skenderaj dhe NS Burim;
Statusi i projektit: për shkak të mos krijimit të kushteve për çkyçe dhe vonesës në liferimin e kthinës transformatorike 10kV, implementimi i projektit është zgjatur deri në Q2 2017;
- 8) Instalimi i transformatorit TR3 në NS 110/10 (20) kV – Prishtina 2
Statusi i projektit :Projektit ka përfunduar dhe është në afatin garantues;
- 9) Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Berivojcë dhe NS Viti
Statusi i projektit: Projekti ka përfunduar dhe është në afatin garantues;
- 10) Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes KOSTT/KEDS
Statusi i projektit: Projekti ka vazhduar me implementim në vitin 2016 dhe deri tani janë përfunduar në total 85% e punëve . Për shkak të mos realizimit të shkyqeve dhe ndikimit të projekteve tjera që janë në implementim, projektit i është vazhduar afati i implementimit deri në Q32017.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 52 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

11) Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike

Statusi i projektit : Projekti është në fazën e implementimit është zgjatur afati i implementimit ;

12) Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Prizreni 2;

Statusi i projektit: Projekti ka përfunduar me vonesë; për atë janë aplikuar edhe penaltitë ndaj kontraktuesit. Projekti është në afatin garantues.

13) Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit faza IV &V" kontratë kjo që është e nënshkruar në Q1 2015 dhe është e ndarë në 4 LOT-e:

Statusi i projekteve: Projektet kanë filluar me implementim në Qershor 2015 dhe janë në fazën e implementimit të punëve ndërtuese , instaluese konform kontratës;

LOT 1: Nënstacionet

- *Ri-vitalizimi i NS Peja 1 (GIS) (5.0 muaj para afatit kontraktual të kompletimit),*
- *Ndërrimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4: 73% e punëve janë kompletuar;*
- *Grupet Matëse në pikat interkonektive: 42 % e punëve janë kompletuar;*
- *Fushat transformatorike 400/110kV në NS Peja 3 dhe NS Ferizaj 2 janë kompletuar (1.5 muaj para afatit kontraktual të kompletimit);*

LOT 2 - Transformatorët Energjetikë

- *Instalimi i auto transformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS Peja 3 dhe NS Ferizaj 2 (1.5 muaj para afatit kontraktual të kompletimit);*

LOT 3 - Linjat transmetuese

- *Linja e re e 110kV e dyfishte NS Peja 3 - NS Peja 1 ka përfunduar 100% ;*
- *Revitalizimi I linjës110kV L126/2 NS Peja 2- NS Decan pritet fillimi i punëve në fillim të vitit 2017;*
- *Instalimi i OPGW në linjat interkonektive ka përfunduar 100% ;*

LOT 4 - Rehabilitimi i 19 nënstacioneve

- *Në NS VITI 67% e punëve janë kompletuar*
- *NS PR 4 45% e punëve janë kompletuar*
- *NS Lipjan 35% e punëve janë kompletuar*
- *Sistemi kontrollues në NS Kos B , NS Podujevë dhe NS Besian 15% e punëve janë kompletuar*
- *Shpenzimet vehtanake AC/DC në NS 110kV – 12% e punëve janë kompletuar*
- *NS Peja 1 – furnizimi me pajisjet 10KV – 50% e punëve janë kompletuar*

14) Revitalizimi i Nënstacioneve 110kV, ana 35kV (Gjilani 1 dhe Ferizaj 1)

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 53 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

- *Statusi i projekteve– projekti është në fazën e implementimit dhe 80% e punëve janë kompletuar. Në NS Gjilani 1, 98.5 % e punëve janë kompletuar, ndërsa në NS Ferizaj 1 janë përfunduar 50% e punëve;*

15) Shërbime të Konsulencës për përgatitjen e tender dosjes për “Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës” të financuara nga BERZH (EBRD).

Statusi i projekteve: në maj të vitit 2016 është përfunduar kontrata për shërbime konsulente..Konform procedurave konsulencia ka përgaditur tender dosjen në tre LOT: LOT1 janë përfshirë nënstationet, LOT 2 –transformatorët e fuqisë dhe LOT 3 – linjat transmetuese dhe ato kabllorike për kycjen e nënstationeve .Është shpallur tenderi, konform Rregullave dhe Politikave të Prokurimit të BERZH-it .. Afati i dorëzimit të ofertave nga tenderuesit e ndryshëm, përmes platformës elektronike ECEPP (BERZH) (<https://ecep.ebrd.com>), është 23.02.2016. Kompania konsulentë ka marrë pjesë në fazën e evaluimit dhe përzgjedhjen e ofertuesit më të mirë për tre LOT–a .

16) Shërbimet konsulente për Menaxhimin e implementimin Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovë BERZH ;

Statusi i projektit: Në Qershor është nënshkruar kontrata.

17) LOT 1 – Nënstationet [110/10(20) kV - NSPrishtina 6 dhe 110 kV HIS në NS Prishtina 4], [110/10(20) kV – NS Mitrovica 2], [110/10(20) kV - NS Theranda] dhe [220/10(20) kV – NS Drenasi 2];

Statusi i projektit: Në Qershor 2016 është nënshkruar kontrata dhe projekti është në fazën e dizajnit;

18) LOT 2 - Transformatorët Energjetikë, (2x40 MVA në NS Prishtina 6, 2x40 MVA në NS Mitrovica 2 dhe 2x40 MVA në NS Drenasi 2);

Statusi i projektit: Në Qershor 2016 është nënshkruar kontrata dhe projekti është në fazën e dizajnit;

19) LOT 3 - Linjat dhe kabllot transmetuese [linja 110 kV e njëfishtë NS Rahoveci – NS Theranda], [linja 110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike NS Fushe Kosova], [linja 220 kV e dyfishtë Drenasi 2], [linja 110 kV e dyfishtë NS Mitrovica2] dhe [linja 110 kV e dyfishtë kabllorike NS Prishtina 6 – NS PR 4]

Statusi i projektit: Në Qershor 2016 është nënshkruar kontrata dhe projekti është në fazën e dizajnit;

Gjatë vitit 2016, kanë vazhduar angazhimet në procesin e integritimit të KOSTT në mekanizmat Rajonal dhe Evropian.

Në përmbushjen e objektivave, një nga të cilat është edhe integrimi rajonal, KOSTT vazhdon edhe më tutje të ballafaqohet me shumë sfida që paraqiten në procesin e integritimit në mekanizmat rajonal.

Në përmbushjen e zotimeve të 6 shteteve të Ballkanit, e njohur si iniciativa e WB6 për themelimin e tregut të organizuar (spot market), tregut rajonal balancues dhe alokimit rajonal të kapaciteteve interkonektive , KOSTT nuk mund të plotësojë kërkesat pasi që i është pamundësuar të zbatojë marrëveshjen e nënshkruar me ENTSO-E (tetor 2015) dhe të veprojë si Zonë rregulluese/Zonë tregtare. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes për Kycje në

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>ver. 1.1</i>		<i>faqe 54 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

mes të ENTSO-E dhe operatorit të sistemit të transmisionit të Kosovës, të nënshkruar në tetor 2015, u kushtëzua nga një licencë furnizimi që duhet lëshuar për një furnizues nga Serbia në Kosovë. Nga ana tjetër është Serbia, që ka dështuar të regjistrojë një kompani të furnizimit dhe kjo mos marrëveshje ende mbetet e pazgjidhur. Progresi i vetëm që është bërë në këtë drejtim është përfshirja e KOSTT në ITC Multiyear Area.

Për këtë arsye MZHE, ZRRE-së dhe KOSTT më 27 prill 2016 nuk kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në kuadër të WB6 të mbështetur nga SKE, qëllimi i të cilit është integrimi i plotë i tregut të energjisë elektrike dhe siguria e furnizimit në WB6, si një hap i parë drejt tregut rajonal të energjisë elektrike në gjithë rajonin e EJL.

Ligjet e energjisë në Kosovë të miratuara në qershor 2016, mundësojnë krijimin e tregut DAM dhe bashkim të tregut si dhe lejojnë aplikimin e procedurës së thjeshtuar të tenderimit në prokurimin e energjisë elektrike.

KOSTT dhe OST e Shqipërisë, janë duke punuar në projektin për krijimin e bursës (PX) së përbashkët e që është hap i parë drejt integritimit në tregun rajonal. Kjo në masë të madhe varet nga krijimi i tregut të organizuar një ditë para (Day ahead) në Shqipëri dhe funksionalizimit të KOSTT si Zonë Rregulluese.

Ligji i miratuar për energjinë elektrike përcakton obligimin e TSO të prokurojë shërbimet balancuese në një procedurë transparente, jo diskriminuese bazuar në treg. Operatori i Tregut ka zhvilluar dhe ZRRE-ja ka miratuar metodologjinë për llogaritjen e çmimit të jo balancit. Nga 01 tetor 2016 ka filluar një dry –run i implementimit të mekanizmit balancues. Implementimi i plotë i mekanizmit balancues është paraparë të fillojë më 01.04.2017 me fillimin e vitit të ri tarifor.

KOSTT është i vetmi aksionar i SEE CAO që ka investuar në ngritjen e kompanisë dhe nuk i shfrytëzon ende shërbimet nga SEE CAO. Kapacitetet interkonektive të KOSTT alokohen në mënyrë të paligjshme dhe pa asnjë autorizim nga EMS. KOSTT ka nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit për themelimin e një nisme rajonale të koordinimit të sigurisë me operatorët e sistemit të transmisionit të Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë, IRJ të Maqedonisë dhe Turqisë. Në tetor 2016 KOSTT së bashku me ADMIE dhe ESO ka nënshkruar marrëveshjen për vendosjen e EJL-RSC në Selanik duke qenë të vetëdijshëm se edhe këto shërbime nuk do të mund ti shfrytëzojnë deri në funksionalizimin e KOSTT si Zonë Rregulluese.

Një nga objektivat strategjike të KOSTT është edhe kujdesi për shëndetin e punëtorëve, e cila është realizuar me projektin e sigurimit shëndetësor suplementar për të gjithë punëtorët. Implementimi i sigurimit shëndetësor ka ndikuar në mbajtjen e shëndetit të mirë të punëtorëve, në motivimin e punëtorëve për punë dhe arritjen e objektivës për të qenë punëdhënës atraktiv. Mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin e punëtorëve gjithashtu do të ndikojë edhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Në kuadër të kujdesit shëndetësor si kërkesë obligative ligjore me qëllim të përcjelljes permanente të gjendjes shëndetësore të punëtorëve, hyjnë edhe kontrollet sistematike

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 55 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

mjekësore, të cilat janë realizuar nga shumica e punëtorëve e sidomos atyre në vendet e punës në kushte specifike.

Për qëllim të arritjes së objektivave të saj KOSTT, gjithmonë është orientuar në krijimin e kushteve sa më të mira të punës për të gjithë punëtorët e saj. Për këtë qëllim janë realizuar shumë projekte të cilat do ti mundësojnë një vend pune në të cilën ata do të ndihen më mirë në realizimin e detyrave të tyre dhe arritjen e një performance më të mirë. Duke pasur parasysh këtë, investimet janë bërë duke filluar prej rregullimit të zyrave dhe ambientit tjetër të punës në të gjitha objektet e KOSTT. Kujdes i veçantë i është kushtuar mbrojtjes së mjedisit - duke larguar materialet e rrezikshme për shëndetin, si psh. sallonit/nga kulmet e Ndërtesave komanduese si në NS Gjakova 2; Efijencës së energjisë – duke përdorur materiale termike, ndriçimit eficient dhe burimeve alternative të energjisë - duke vendosur panelet solare, si dhe krijimit të hapësirave të reja për punë dhe hapësirave të gjelbëruara në NS - duke krijuar kushtet më të mira për të gjithë punëtorët e saj, në harmoni me standardet më të larta.

KOSTT i kushton kujdes të veçantë sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, sigurisë së aseteve dhe menaxhimit mjedisor duke përbushur: furnizimin me pajisje mbrojtëse; informimin dhe përkrahjen gjatë implementimit të sistemit të ri të dokumentacionit për zbatimin e procedurave për punë të sigurt gjatë mirëmbajtjes për linja, nënstacione dhe për kontraktues; inspektimin/monitorimin në teren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesin gjatë realizimit të projekteve; largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese; angazhimin mbi zhvillimin e projektit për siguri dhe mjedis dhe sipas planit zhvillimor; zhvillimin e dokumentacionit për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndeti në punë si dhe sistemin e menaxhimit të mjedisit si: lëndimet në punë, transporti dhe bartja e ngarkesave, ndikimi i rrymës elektrike në trupin e njeriut, rregullat dhe masat e sigurisë gjatë punës në objekte elektroenergjetike-versioni 2.0, ndihma e parë në vendin e punës, Manuali mjedisor- edukativ, procedurat për veprimet korrigjuese dhe parandaluese për aspekte mjedisore; zhvillimi dhe mbajtja e programeve trajnuese për punëtorë si: rreziku nga rryma elektrike dhe realizimin e tokëzimit në vendin e punës, rreziku nga lartësitë – Ngjitja në shtylla dhe puna në linja ajrore, menaxhimi i mjedisit-mbrojtja e mjedisit dhe rreziqet fizike dhe kimike; bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale etj.

Është realizuar integrimi i rrjetave të NS 110kV/x me rrjetin e KOSTT përmes infrastrukturës komunikuese.

Është realizuar me sukses migrimi nga TMG (Threat Management Gateway) në NGFW (Next Generation Firewall). Implementimi i këtij projekti do të rris nivelin e sigurisë së sistemit të TI-së, si në aspektin e qasjes në sistem të TI nga jashtë ashtu edhe në aspektin e ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave të KOSTT, do të mundësoj monitorimin e komunikimeve, filtrimin e ueb faqeve, qasjen e sigurt të stafit të TI-së në sistem përmes

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 56 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

VPN etj. Gjithashtu, janë përgatitur termat e referencës si një dokument kornizë për projektin për krijimin e qendrës për rikuperim të të dhënave në rast të katastrofave (QRK).

KOSTT edhe gjatë vitit 2016 si edhe deri më tani ka ofruar mbështetje për kryerjen e praktikës profesionale për studentë. Edhe këtë vit KOSTT dhe FIEK (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike) kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi për implementimin e praktikës profesionale, veçanërisht për studentet e fakultetit të inxhinierisë elektrike duke iu ofruar mundësinë e punës praktike në KOSTT në harmoni me programet adekuate, i cili bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje. Numri i studentëve të fakultetit të Inxhinierisë elektrike gjatë vitit 2016 është 13 studente dhe 5 të tjerë.

Po ashtu KOSTT-i ka lidhur një marrëveshje tjetër me “AECOM International Development” kompani e financuar nga USAID, për implementimin e punës praktike për inxhinierë të rinj – studentët e fakultetit të Inxhinierisë elektrike kryesisht të nivelit Master. Ky projekt është implementuar në dy grupe deri tani. Grupi i parë i përberë nga 6 inxhinierë kanë përfunduar me sukses punën praktike gjatë vitit 2016, ndërsa grupi i dytë ne përbërje prej 6 inxhinierëve- studente ka filluar në muajin tetor dhe është duke vijuar edhe tani deri muajin prill.. Ky projekt do të vazhdojë edhe gjatë viti 2017.

Është investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve me realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese. Gjatë këtij viti ka pasur angazhim të punonjësve të KOSTT duke marrë pjesë në grupe punuese edhe pse pjesëmarrja e KOSTT-it në disa grupe punuese regjionale ende nuk është e barabarte me pjesëmarrësit e OST tjera regjionale. KOSTT-i ka përkrahur vazhdimisht pjesëmarrjen në të gjitha grupet punuese me qëllim të informimit dhe aftësimit të stafit me të arriturat dhe zhvillimit regjionale e më gjerë.

Ndërlidhur me procesin e menaxhimit të cilësisë, KOSTT ka zhvilluar sistemin e menaxhimit të cilësisë në përbërje prej tri standardeve. ISO 9001:2015; ISO 14001: 2015 dhe OHSAS 18001:2007. KOSTT ka implementuar me përpikëri kërkesat sipas standardit ISO 9001:2015, përfshirë procesin e tranzicionit nga ISO 9001:2008 në ISO 9001:2015. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe KOSTT ka plotësuar me përpikëri edhe kërkesat e dy standardeve të reja në KOSTT ISO 14001: 2015 dhe OHSAS 18001:2007 dhe njëkohësisht ka ndërtuar Sistemin e Integruar të Cilësisë (SIM) prej tri standardeve të lartë përmendura. Sistemi i Integruar i Cilësisë (SIM)n është funksional dhe në shfrytëzim të të gjithë stafit dhe në të gjitha NS-të e KOSTT dhe është i harmonizuar me të gjitha sistemet tjera. KOSTT tani është në proces të certifikimit të Sistemit të Integruar të Menaxhimit nga një trupë certifikuese ndërkombëtare.

KOSTT-i operon brenda një kornize rregullative të bazuar në ligje, licenca dhe në legjislacionin sekondar të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE).

Të gjitha dokumentet, raportet e rregullta dhe të dhëna apo raporte sipas kërkesave të ZRRrE-së dhe të MZHE-së, janë dërguar në afatin e paraparë.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 57 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Nga perspektiva e Planit të Biznesit, aspekti më i rëndësishëm rregullativ është përcaktimi i të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave nga ana e ZRrE-së. Në bazë të Rregullit për Vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, KOSTT ka dorëzuar te ZRrE propozimin për të Hyrat Maksimale të lejuara për vitin 2016, si dhe aplikacionin për tarifa që do të zbatohen gjatë vitit relevant tarifar.

KOSTT ka përgatit format e të dhënave në dispozicion dhe publikimin e tyre në faqen e vet elektronike sipas Platformës së Transparencës, platformë qendrore e ENTSO-E në përputhje me rregulloren(EU) nr.543/2013 e cila siguron qasje të vazhdueshme për të gjitha të dhënat për tregun për OST-të pjesëmarrëse. Me fillimin e operimit të pavarur të KOSTT si zonë/blok rregullues do te publikohen të dhënat që ndërlidhen me funksionimin e KOSTT si zonë e pavarur rregulluese.

KOSTT beson që përgjegjësia dhe transparenca ndaj aksionarit dhe palëve të tjera të interesit janë ndër parimet bazë në përmbushjen e mandatit të saj si institucion publik. Duke e vlerësuar reputacionin si një aset i cili kontribuon në vlerën e kompanisë si dhe ndihmon në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e besimit të palëve interesit, KOSTT sh.a në mënyrë të vazhdueshme mirëmban dhe punon në avancimin e mëturtyeshëm të imazhit pozitiv tashmë të krijuar të kompanisë, si dhe në avancimin e raporteve me palët e interesit. Gjatë vitit 2016 janë implementuar aktivitete në përputhje me strategjinë e komunikimit, në drejtim të informimit të drejtë të opinionit publik në lidhje me aktivitetet dhe veprimtarinë e KOSTT, janë realizuar publikime dhe organizuar ngjarje të cilat në këtë vit kanë qenë kryesisht të karakterit të vizitave të delegacioneve të larta nga institucione vendore dhe ndërkombëtare. Në vitin 2016 për herë të parë në Kosovë ka filluar publikimi në webfaqe të KOSTT i “Të dhënave të Transparencës” sipas obligimeve nga Rregullorja e Bashkimit Evropian nr.543/2013, që përfshijnë të dhënat për parashikimin dhe realizimin në kohë reale të ngarkesës së Sistemit Transmetues dhe gjenerimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës si dhe planifikimi i shkyçjeve.

Me 1 korrik 2016, janë mbushur 10 vjet që nga themelimi i KOSTT si Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës. Gjatë 10 viteve të funksionimit të KOSTT si kompani publike, janë shënuar të arritura të shumta duke ndërtuar kështu imazh të një kompanie publike të suksesshme, jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Është draftuar plani për shenimin e 10 vjetorit të kompanisë me palë të interesit ku ndër të tjera është parapa organizimi i një konference ndërkombëtare për energji si dhe plani për shenimin e 10 vjetorit brenda kompanisë. Për shkak të situatës së krijuar në pritje të fillimit të implementimit të Marrëveshjes për Kycje me ENTSO-E, nuk janë implementuar. Në simbolikë të 10 vjetorit janë ndarë mirënjohje për: Projektin me ndikim të madh në Sistemin Transmetues të Kosovës; Për kontribut të veçantë në funksionimin/operimin e Sistemit Transmetues të Kosovës si dhe Për Ekipin e Mirëmbajtjes të Sistemit Transmetues të Republikës së Kosovës.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 58 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Për të vizualizuar të arriturat e KOSTT në 10 vite të funksionimit është realizuar filmi dokumentar “KOSTT-Një dekadë rrugëtim i suksesshëm”.

Në kuadër të zbatimit të praktikave të CSR (Corporate Social Responsibility) në vitin 2016 KOSTT ka zhvilluar një iniciativë unike në shërbim të komunitetit të biznesit vendor, duke promovuar prodhimet vendore që janë unike për Kosovë si dhe me gjerë në rajon. Tri parimet që këtë vit janë zgjedhur janë: fuqizimi i femrës, përkrahja për prodhimet unike vendore dhe respekti për humanisten dhe misionaren me origjinë shqiptare Nënë Tereza e cila u shenjtërua në vitin 2016. KOSTT ka vazhduar aktivitetet përmes rrjetit të bizneseve të përgjegjshme Kosovo CSR Network në kuadër të së cilës edhe ka nënshkruar Paktin Evropian të Rinisë, i lansuar nga CSR Europe (Bruksel), në Kosovë nën Patronatin e Lartë të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe me mbështetje nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Përmes Paktit, palët zotohen që bashkërisht do të angazhohen për të krijuar mundësi të reja për punë praktike, trajnime, zanatësi dhe/ose punësim direkt për të rinjtë. Pjesë e këtij projekti janë edhe 28 shtete anëtare të BE.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 59 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2016

Emri i Projektit	Buxheti	Financuar nga	Vlera e Kontratës	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Buxheti Shpenzuar Q1-Q4/2016
<i>SCADA/EMS & Telekom</i>	17,987,563.00	Grant / BK	17,987,563.00	Q4 2009-	Q2-2012	Alstom/ Komtel (F/RKS)	163,946.80
<i>Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1</i>	30,500,000.00 €	KjW e KOSTT (kredit)	30,773,968.59 (pa taksa e dogana) me taksa e dogana (36,000,000€)	Q4-2013	Q4-2016	Dalekonod d.d.	3,045,256 €
<i>Rregullimi sekundar Kosove - Shqipëri (kfW +Kredit)</i>	5,800,000.00€	KjW/KOSTT Kredit	5,392,964.00 €	Q4 2013	Q4 2016	ABB - AG	1,479,342 €
<i>Shpronësimi i tokave dhe kompensimi i dëmeve për projektet e financuar nga buxheti vetanak i KOSTT-it</i>	1,314,000.00 €	KOSTT	.	Q1 2013	Q4-2017	.	160,309 €
<i>Rialokimi i linjës 110kV , nr.1806 NS Gjakova 1 - Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1</i>	1,500,000.00 €	KOSTT	3,267,253.00	Q2 2011	Q4 2015	Ukab (RKS)/ELSA (Si)	0.00€

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 60 nga 94</i>
Departamenti Financiar		Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

LOT1: <i>Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS Gjakova 2</i>	2,100,000.00 €	KOSTT	1,973,912.00 €	Q1 2013	Q3 2016	Ukab	400,581.95 €
LOT2: <i>Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3</i>	2,100,000.00 €	KOSTT	1,796,234.47 €	Q1 2013	Q3 2016	Ukab	429,923.86€
<i>Revitalizimi I nënstacioneve NS 110kV ana 35 kV NS Gjakova 1,</i>	1,000,000.00€	KOSTT	416,577.46€	Q4 2013-	-Q4 2017	NP"MONTEN" dhe NTSH"ELING"	25,508 €
<i>Instalimi I TR 2 ne NS 110/10(20) Skenderaj \$ NS Burim me punët shtese</i>	1,500,000.00€	KOSTT	1,679,626.13€	Q2 2014	Q3 2016 - Q@2017	Ukab	389,752 €
<i>Instalimi i transformatorit TR3 në NS 110/10 (20) kV – Prishtina 2 me punët shtesë</i>	1,150,000.00€	KOSTT	1,096,464.5€	Q4 2014	Q2 2016	MONTEN	198,662 €
<i>Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Berivojcë dhe Viti (me punë shtesë)</i>	850,000.00€	KOSTT	713,469.02€	Q2 2015	Q4 2016	N.T.Sh . Monting	196,453 € €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 61 nga 94</i>
Departamenti Financiar		Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

<i>Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH</i>	2,500,000.00€	KOSTT	2,327,240.19€	Q42014	Q42016 Q3 2017	Monten & G3 Inxhinering	654,570 €
<i>Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike</i>	3,300,000.00€	KOSTT	3,270,780.43€	Q12014-	Q42016	Alstom ,Komtel , Koncar	897,839 €
<i>Mbrojtjet Rele të 3 Autotransformatorëve në NS Prizreni 2</i>	65,000.00 €	KOSTT	34,908.46€	Q3 2015	Q2 2016	Ukeab	31,959 €
<i>Revitalizimi i Nënstacioneve 110kV, ana 35kV (Gjilani 1 dhe Ferizaj 1)</i>	400,000.€	KOSTT	296.384.67€	29.02.2016	28.09.2016 Q2 2017	Komtel	91,168.67 €
<i>Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike</i>	2100000	KOSTT	3,300,000 €	Q3 2014 –	Q3 2017	Koncar , Alsom – Komtel	897,839 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 62 nga 94</i>
Departamenti Financiar		Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

<p><i>Shërbimet Konsulente për përgatitje të tender dosjes / projekteve shtesë dhe menaxhimin e projekteve (Project preparation consultant)</i></p>	1,573,833.00€	IPA / KJW / Grant	1,573,833.00 €	Q1 2014	Q4 2018	MVV Decon/Consullectra	450,823 €
<p><i>LOT 1 =Nënstacionet</i> <i>1. Ri-vitalizimi i NS Peja 1(GIS)</i> <i>2. Ndërrimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4 ;</i> <i>3. INTER OST Grupet Matëse në pikat interkonektive ;</i> <i>4. Fushat transformatorike 400/110kV dhe VO1 (496458€)</i></p>	7,649,547.00€	IPA / KJW / Kredit	7,599,902.00€ + 49,648 €	Q2 2015	Q42018	Siemens . Ag	4,340,406 €
<p><i>LOT 2 - Transformatorët Instalimi i auto transformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS Peja 3 dhe NS Ferizaj 2</i></p>	4,443,000.00€	IPA / KJW / Grant	4,443,000.00 €.	Q2 2015-	Q42018	Koncar (Hr.)	1,645,700 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 63 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

LOT 3 - Linjat transmetuese 1. Linja e re e 110kV e dyfishte NS Peja 3 - NS Peja 1; 2. Revitalizimi I linjës 110kV L126/2 NS Peja 2- NS Decan 3. Instalimi i OPGW në linjat interkonektive	8,532,671.00€	IPA / KJW / Grant	8,532,671.00€	Q2 2015-	Q4 2018	Dalekonod .(Hr)	5,321,737 €
LOT 4 - Projekte shtese 1. Rehabilitimi I nënstacioneve NS Viti , NS Lipjan , NS Klinë ; 2. Rehabilitimi I shpenzimeve vetjake AC/DC në nënstacionet 110kV 3. Transformatori I dytë në NS Gjakova 1	10,794,072.00€	IPA/KJW /Kredi	8,722,018 € dhe Opcionale 2,072,054.00€	Q2 2015	Q4 2018	Siemens Ag	1,672,355 €
Shërbimet konsulente për mbështetjen e përgatitjes së propozimit teknik për Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës	800,000.00€	EBRD	389,570.00€	Q2 2015 -	Q1 2016	MVV Decon/ Consultetra	1 318,585 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 64 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

<p><i>Shërbimet konsulente për mbështetjen e përgatitjes së propozimit teknik për Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës</i></p>	1,200,000.00	BERZH / Kredi	1,071,988.25€	Q2 2016	Q2 2018	AF Consult Switzerland Ltd	00.00€
<p><i>LOT 1 -Nënstacionet [110/10(20) kV - Prishtina 6 dhe 110 kV HIS në SS Prishtina 4], [110/10(20) kV - Mitrovica 2], [110/10(20) kV - SS Theranda] dhe [220/10(20) kV - Drenasi 2]</i></p>	20,000,000.00€	BERZH / Kredi dhe KOSTT	19,614,980.67€	16.09.2016	15.09.2018	ABB, Italy/Croatia	1,961,498 €

<p><i>LOT 2-Transformatorët e fuqisë 40MVA 2x40 MVA(in SS Prishtina 6, 2x40 MVA in SS Mitrovica 2 and 2x40 MVA in SS Drenasi 2)</i></p>	<p>4,000,000.00€</p>	<p>BERZH /Kredi dhe KOSTT</p>	<p>3,880,401.28€</p>	<p>16.09.2016</p>	<p>15.09.2018</p>	<p>Hyundai/Balkan Petrol</p>	<p>388,040.13€</p>
<p><i>LOT 3 - Linjat transmetuese [110 kV e njëfishtë NS Rahoveci – NS Theranda], [110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike NS Fushe Kosova], [220 kV Linja e dyfishtë Drenasi 2], [110 kV Mitrovica] and [110 kV Linja e dyfishtë kabllorike Pristina 6</i></p>	<p>7,200,000€</p>	<p>BERZH /Kredi dhe KOSTT</p>	<p>7,663,246.00€</p>	<p>03.10.2016</p>	<p>03.10.2018</p>	<p>S. C. Romelectro, Romania</p>	<p>766,324.60€</p>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 66 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Ashtu si edhe deri më tani, përpjekjet e KOSTT-it, do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti), në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin.

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit gjatë vitit 2017, do të jenë:

- Legjislacionit sekondar i cili duhet të zhvillohet nga KOSTT dhe ZRrE në pajtueshmëri me kërkesat nga Ligjet e reja të Energjisë respektivisht: Ligji për Energji, Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 05/L – 081) Elektrike (Ligji Nr. 05/L – 085) dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L – 084) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në qershor të vitit 2016.
- Implementimi i Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E;
- Fillimi i operimit të KOSTT si zonë rregulluese/bllok rregullues më vete në përputhje me rregullat e ENTSO-E;
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Sekondar me OST;
- Implementimi i marrëveshjeve Ndër- OST me OST-të fqinje;
- Implementimi i Mekanizmit Balancues si kërkesë në Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë dhe Rregullave të Tregut;
- Rifreskimi i platformave softuerike ekzistuese, trajnimi dhe edukimi i stafit për përdorimin e tyre. Platformat softuerike si SCADA/EMS, Sistemi për Menaxhimin e Energjisë e Tregut, Kontrolli Frekuencë Fuqi-LFC, analiza e sigurisë së operimit një ditë para i njohur si DACF- (Day Ahead Congestion Forecast), Softuer për mbikëqyrje dhe kontroll në kohën reale, pajisjeve të TL të tipit T 5000, E-TERRA Habitat, do të mundësojnë dhe lehtësojnë kryerjen e aktiviteteve të të gjitha palëve pjesëmarrëse në tregun e energjisë, për të siguruar operim më eficient të sistemit të energjisë elektrike;
- Vazhdimi i investimeve në rrjetin e transmisionit për të arritur standarde të larta të shërbimeve ndaj klientëve dhe ngritja e efikasitetit të afarizmit financiar;
- Shqyrtimi i aplikacioneve për kyçe në sistemin e transmetimit, përgatitja e Marrëveshjeve të Kyçjes dhe nënshkrimi
- Eksploatimi maksimal i infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese që më saktësisht konsiston në:

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 67 nga 94</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

1. Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rjetit transmetues nga Qendra Nacionale Dispečerike Kryesore dhe Emergjente;
2. Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS;
3. Kompletimi i krijimit të kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me OST-të fqinje në kohën reale.

Në aspektin e operimit, gjatë planit afatshkurtër do të implementohet edhe projekti i Kontrollit Frekuncë-Fuqi në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë, i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshojë regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në tri variante:

- Operimi si dy Blloqe Rregulluese të veçanta me shkëmbim të shërbimeve ndihmëse
- Operimi me dy zona rregulluese të ndara në një Bllok rregullues me Shqipërinë, ose
- Operimi në një zonë të përbashkët në fazat e mëvonshme.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Kyçje mes KOSTT dhe ENTSO-E, ka qenë e paraparë që nga 30 nëntor 2015 KOSTT të fillojë të operojë si Zonë/Bllok Rregullues në kuadër të Evropës Kontinentale. Mirëpo për arsye politike ky proces është prolonguar për një kohë. KOSTT shpreson që nga qershori 2017 do të mund ta ushtrojë rolin e tij si Zonë/Bllok Rregullues.

Modi i ri i operimit përfshin kryesisht aktivitetet që ndërlidhen me bashkëpunimin e OST-ve të interkonektuara, me qëllim të operimit të sigurt të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimet e respektimit të rregullave të ENTSO-E. Për të filluar operimin si zonë/bllok rregullues, në vitin 2017, në KOSTT duhet të arrihen dy objektiva kryesore:

- Ngritja e kapacitetit të stafit të Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut për të performuar me punët e reja që ndërlidhen me operimin e KOSTT si zonë/bllok rregullues dhe implementimin e marrëveshjeve operative me ENTSO-E dhe OST-të fqinje, në veçanti me:
